


Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025

Draft



Tiranë, Janar 2020

Lista e Shkurtimeve

AT	Asistencë Teknike
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
CAMS	Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve i Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterëve
DHKPGJP	Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjK	Gjykata Kushtetuese
GjL	Gjykata e Lartë
GP	Grup Pune
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IT	Teknologjia e informacionit
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
SDG	Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SNSD	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SNZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPAK	Struktura e Posaçme Anti Korrupsion
TF	Task Forca

Përmbajtja e lëndës

Lista e Shkurtimeve	2
PJESA I: KORNIZA STRATEGJIKE.....	4
1. Përmbledhje e shkurtër dhe qëllimi i Strategjisë.....	4
2.1 Korniza Ligjore.....	7
Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).....	9
2.2, Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës gjatë periudhës 2016-2020	9
2.3 Koncepti për fazën e strategjisë së re	12
Terminologjia.....	16
3 Vizioni i Strategjisë.....	17
3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultateve.....	21
PJESA II –QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SND 2021-2025	25
4 Qëllimi i Politikës 1– Qeverisja, pavarësia dhe llogaridhënia në sistemin e drejtësisë	25
5 Qëllimi I Politikës 2 – Gjyqësori: Aksesi, Efienca dhe Transparenca	27
6 Qëllimi i Politikës 3 – Një Sistem i Drejtësisë Penale i cili mbështetet në risocializim, riintegrim dhe rehabilitimin, si dhe respekton të drejtat e njeriut	29
7 Qëllimi i Politikës 4 - MD dhe menaxhimi e koordinimi i sektorit	32
PJESA III: ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI	35
9 Koordinimi, Monitorimi dhe Menaxhimi i Performancës	35
10 Komunikimi i Strategjisë	37
11 Matrica e menaxhimit të riskut.....	39
Pjesa IV – KONSIDERATA FINANCIARE	45
12 Buxheti i Strategjisë	45
PJESA V: Anekset me planet e veprimit, treguesit dhe buxhetet e hollësishme	49

PJESA I: KORNIZA STRATEGJIKE

1. Përmbledhje e shkurtër dhe qëllimi i Strategjisë

Reforma në Drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Institucionet e sistemit të drejtësisë janë angazhuar plotësisht për të krijuar një sistem në përputhje me standardet që duhet të përmbushë një vend në pritje të çeljes së negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Pas përfundimit të fazës së parë të reformës në drejtësi, e zyrtarizuar me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2016-2020 (SND I), Qeveria Shqiptare vijoi me hartimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 (SND 2021-2025), me qëllim përqasjen e sistemit të drejtësisë në Shqipëri me standardet më të mira evropiane. Teksa faza e saj e parë krijoi bazën kushtetuese, ligjore dhe institucionale për përgatitjen e sistemit të drejtësisë për të arritur standardet evropiane, faza 5-vjecare në vijim (2021-2025) do t'i shërbejë konsolidimit të mëtejshëm të kësaj kornize, duke vijuar më pas me fazën përfundimtare (2026-2029), e cila do të ketë për qëllim ofrimin e shërbimeve në sektorin e drejtësisë në nivelin e standardeve evropiane.

Gjatë fazës së parë të reformës në drejtësi u shënuan një sërë arritjesh. Më datë 22 korrik 2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi amendamentet kushtetuese në kuadër të Reformës në Drejtësi, të cilat hynë në fuqi më 11 gusht 2016. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese u pasua nga miratimi i një liste gjithëpërfshirëse të ligjeve që synojnë fuqizimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë, të cilat përfshijnë:

- 7 ligje të nivelit organik;
- ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar;
- miratimin e ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, si dhe
- 30 ligje të tjera që janë miratuar ose janë në proces miratimi, ndër to, edhe ligje që normojnë veprimtarinë e profesioneve të lira ligjore, si dhe paketa e ligjeve të sistemit penitenciar.

Bazuar në reformën kushtetuese u ristrukturuan institucionet që qeverisin sistemin e drejtësisë në Shqipëri dhe u krijuan një sërë institucioneve të reja. Konkretisht, janë krijuar dy institucione të pavarura vetëqeverisëse përgjegjëse për mbikëqyrjen e gjyqësorit dhe Prokurorisë, përkatësisht Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Me qëllim rritjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, çështjet e karrierës dhe masat disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve shqyrtohen tashmë nga KLGJ dhe KLP. Hetimi dhe verifikimi i ankesave iu besua një organi të ri kushtetues, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), i cili është përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe hetimin e sjelljeve disiplinore të

gjyqtarëve dhe prokurorëve, anëtarëve të KLGJ-së, KLP-së, si dhe Prokurorit të Përgjithshëm (PP). Për herë të parë, në Kushtetutë u parashikua një kuadër i plotë institucional në drejtim të hetimit dhe gjykimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmes krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit/Njesisë së Posaçme Hetimore si dhe gjykatatës së shkallës së parë dhe të apelit për krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Gjithashtu, Gjykata e Lartë (GJL) është kthyer në një gjykatë karriere brenda pushtetit gjyqësor, ndërsa roli i PP-së është kufizuar në atë të funksionimit të duhur administrativ të Prokurorisë, ku secili prokuror është tashmë i pavarur në hetime dhe marrje vendimesh.

Një nga qëllimet e Reformës në Drejtësi ishte rivendosja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe siguri i pavarësisë dhe funksionimit të duhur të këtij të fundit. Për këtë arsye, mbi bazën e një kuadri të plotë kushtetues dhe ligjor është duke u zhvilluar një rivlerësim kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve ("*vetting-u*"), i cili përfshin vlerësimin e hollësishëm të pasurive, aftësive profesionale dhe kontrollin e figurës së rreth 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kjo arkitekturë e re institucionale e sistemit të drejtësisë ka dhënë tashmë rezultatet e para në disa drejtime, përfshirë këtu, ndër të tjera: rezultate tejet pozitive në drejtim të realizimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, emërimet e gjyqtarëve në Gjykatë Kushtetuese (GJK) dhe disa gjyqtarëve të GJL-së nga rradhët e juristëve të shquar, mundësimin e funksionimit të plotë të të gjitha organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ngritjen dhe funksionimin e të gjithë strukturave të specializuara në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Paralelisht, Shkolla e Magjistraturës (ShM) ka vijuar të sigurojë në mënyrë praktike dhe efektive kualifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj dhe atyre në detyrë nëpërmjet kurrikulave të saj të trajnimit. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare dhe Kuvendi janë angazhuar që të garantojnë mbështetje buxhetore dhe infrastrukturore për këto institucione, me qëllim mundësimin e ushtrimit të funksioneve të tyre në mënyrë efikase.

Ministria e Drejtësisë në përputhje me kuadrin ligjor të rishikuar në kuadër të reformës në drejtësi ka ushtruar një sërë funksionesh në drejtim të ngritjes së kapaciteteve dhe ofrimit të shërbimeve qytetarëve në drejtim të rritjes së aksesit në drejtësi. Konkretisht, me krijimin e Drejtërisë së Ndhmës Juridike Falas dhe strukturave përkatëse, bazuar në ligjin nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe 13 aktet nënligjore të miratuara, është bërë funksionale skema e re e ndihmës ligjore falas. Drejtoria e Ndhmës juridike Falas mbikqyr ofrimin e ndihmës juridike falas nga qendrat e ofrimit të ndihmës juridike në 7 qytete të Shqipërisë, si dhe nga OJF e autorizuar dhe klinikat e ligjit në institucionet e arsimit të lartë. Në tërësi, institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë kanë hartuar plane për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve të tyre njerëzore. Po ashtu, janë hartuar edhe Strategji të reja institucionale për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me ekspertët e misionit EURALIUS.

Duke marrë në konsideratë zhvillimet e deritanishme të reformës në drejtësi dhe të të gjitha institucioneve të përfshira në zbatimin e saj, visioni i kësaj faze të dytë të zbatimit të Strategjisë Ndësektoriale të Drejtësisë është:

- ***“Një sistem drejtësie i pavarur, i aksesueshëm, llogaridhënës, transparent dhe efikas që mbrohet nga drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane”***

Strategjia ka katër qëllime kryesore të politikës që shtrihen për zbatim, të cilët janë:

- **Qëllimi i politikës 1:** Funksionimi profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.
- **Qëllimi i politikës 2:** Fuqizimi i transparencës, kompetencës, aksesit dhe efikasitetit të gjyqësorit në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe standardet evropiane.
- **Qëllimi i politikës 3:** Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, duke garantuar risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.
- **Qëllimi i politikës 4:** Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit

Në mënyrë të detajuar, qëllimet e politikave të Strategjisë, sipas objektivave specifike për secilin qëllim të politikës dhe rezultatet e pritshme për secilin objektiv specifik, janë pasqyruar në vijim të këtij dokumenti.

Duke marrë në konsideratë se sistemi i drejtësisë përbëhet nga një numër i konsiderueshëm institucionesh të pavarura, ky dokument është konceptuar si një Strategji ombrellë, e cila do të përmbajë kryesisht objektivat më të rëndësishme dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj, të cilat kanë natyrë të përgjithshme. Ndërsa planet e dedikuara institucionale hartohen dhe zbatohen në mbështetje të Strategjisë, të cilat kanë synim të zbërthejnë në hollësi masat e detajuara që secili institucion do të ndërmarë në përmbushje të secilit qëllim të politikës së Strategjisë. Gjithashtu, Strategjia synon të garantojë fuqizimin e koordinimit dhe politikave të komunikimit nëpërmjet rritjes së performancës dhe mekanizmave të menaxhimit të riskut.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”, procesi për Strategjinë Ndësektoriale të Drejtësisë 2021-2025 nisi me hartimin e Koncept-Dokumentit të kësaj Strategjie, një dokument i konsultuar gjerësisht me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, si dhe i miratuar nga Zyra e Kryeministrit. Mbi këtë bazë edhe planet e Planet e veprimtimit dhe buxhetet e hollësishme janë punuar sipas sistemit IPSIS.

Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit është vlerësuar në shumën 34 milionë Euro. Buxheti përmbledhës është pasqyruar në Kapitullin 11 të këtij dokumenti.

2 Korniza ligjore dhe institucionale, arritjet, mësimet e nxjerra

2.1 Korniza Ligjore

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, së bashku me dokumentet strategjike shoqërues harmonizohet dhe është në përputhje me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II)** sipas shtyllës “*Mirëqeverisja e Mirë, Demokracia, Sundimi i Ligjit*”.

Kjo shtyllë e SKZHI II përfshin, por pa u kufizuar në to - 13 sektorë, përfshirë reformimin e sistemit të drejtësisë, luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmin dhe trafikimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, transparencën, si dhe luftën kundër korrupsionit.

Lidhur me sistemin e drejtësisë në SKZHI II konkretisht parashikohet:

Objektiv Strategjik: **Reformimi i Sistemit të Drejtësisë**

1. Konsolidimi i pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit;
2. Rritja e transparencës dhe konsolidimi i besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë;
3. Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimeve përmbartimore publike dhe private dhe përfundimi i shërbimeve të profesioneve të lira;
4. Garantimi i të drejtave themelore personale dhe shndërrimi i dënimit penal në programe të mundshme të riedukimit;
5. Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së burgjeve dhe i masave të sigurisë në burgje dhe transformimi gradual i mjediseve për të miturit në struktura të hapura ose gjysmë të hapura;
6. Krijimi i një baze të dhënash elektronike për Gjyqësorin.

Qëllimi i politikës

Seksioni 8.1 i SKZHI II “**Reformimi i Sistemit të Drejtësisë**” parashikon, mes të tjerash:

1. Rritje e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, duke përfshirë shmangien e çdo potenciali për politizimin e tij;
2. Përmirësim i transparencës dhe çështjeve të tjera që lidhen me emërimin, ngritjen në detyrë, transferimin, vlerësimin dhe sigurinë e gjyqtarëve;
3. Përsheptim i caktimit dhe menaxhimit të çështjeve gjyqësore;
4. Harmonizim i plotë dhe unifikim i sistemit të praktikës gjyqësore;
5. Qasje më e mirë e publikut në informacionin përkatës;
6. Qartësi mbi rolin dhe përgjegjësinë e institucioneve gjyqësore;
7. Luft kundër rasteve dhe/ose pretendimeve të lidhura me korrupsionin, dhe
8. Rritja e efikasitetit dhe aftësive të institucioneve gjyqësore.

Strategjia është harmonizuar me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e strategjive ndërsektoriale të mëposhtme: Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-

2025, Strategjia Ndërsektorale të luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm 2013-2020, Strategjia Ndërsektorale për decentralizimin dhe qeverisjen lokale 2014-2020, Strategjia Ndërsektorale e Reformës së Administratës Publike 2015-2020, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, Strategjia Ndërsektorale “Agjenda Digitale e Shqipërisë 2015-2020”, Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018-2020, Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Plani i Veprimit, si dhe strategji të tjera përkatëse.

Lidhja me Programin Qeveritar 2016-2021

Në zbatim të Programit Qeveritar 2016-2021 dhe konkretisht Prioritetit nr.3 ‘Shërbimet Publike’, Seksioni 3.1 “Shteti i së Drejtës dhe Drejtësia e re”, synohet të ketë një gjithëpërfshirje përmes:

- mbështetjes për përfundimin e procesit të vetting-ut dhe krijimit të institucioneve të reja të qeverisjes së drejtësisë, si parakusht për zbatimin e suksesshëm të reformës në drejtësi;
- reformës së hartimit të legjislacionit dhe në përgjithësi të sistemit të kodifikimit; - reformës së përgjithshme të shërbimeve publike që kanë të bëjnë me drejtësinë në lidhje me titullin e pronësisë, përfshirë regjistrimin, kthimin dhe kompensimin;
- reformës së shërbimeve publike të ofruara nga profesionet e lira (noteri, avokatët, ndërmjetësit);
- reformimit të thellë të sistemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përmes shërbimit të përmbaruesve;
- reformimit të institucioneve penitenciare, burgjeve dhe institucioneve të paraburgimit, si dhe shërbimit të provës, duke synuar maksimizimin e efektivitetit të tyre;
- reformimit të shërbimeve publike nën Platformën e Bashkëqeverisjes, me synimin që qytetarët të dëgjojnë kur ata kanë ankesa kundrejt shërbimeve të ofruara jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Lidhja me PKIE & Acquis të BE-së

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Neni 78 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare dhe BE dhe, anëtarëve dhe Republikës së Shqipërisë, “Rifuqizim i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2018–2020,¹ Seksioni 1.1 “Demokracia” parashikon që veprimet e ndërmarra nga Qeveria e Shqipërisë në kuadër të reformës në drejtësi dhe sundimit të ligjit kanë si qëllim kryesor garantimin e një sistemi gjyqësor të paanshëm, efektiv dhe të përgjegjshëm, i cili është në gjendje të sigurojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe të zbatojë legjislacionin e përafëruar me *acquis*-në e BE-së. Më tej, Kapitulli 23, Seksioni II.1 “Funksionimi i gjyqësorit” i PKIE 2018-2020 parashikon që reformat do të

¹ VKM nr.246 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018–2020”.

zbatohen duke synuar harmonizimin e sistemit gjyqësor shqiptar me standardet e BE-së në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë, llogaridhënien, cilësinë dhe efektivitetin e drejtësisë. Objektivat strategjike janë:

- mbështetja për krijimin e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
- përmirësimi i aksesit në drejtësi, në veçanti për grupet në nevojë;
- zbatimi i reformës në drejtësi në lidhje me të miturit në konflikt me ligjin, duke përmirësuar drejtësinë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale.

Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

OZHQ 16 promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Lidhja me angazhime/marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë (2006), Këshilli i Evropës (1995)/Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Rezoluta 109 (1955) e 14 Dhjetorit 1955 mbi pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Lidhja me Strategjitë institucionale të institucioneve të pavarura të Drejtësisë

SND 2021-2025 është harmonizuar me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e Strategjive të mësipërme të miratuara si dhe të Strategjive të institucioneve të pavarura të drejtësisë: KLGJ, KLP, ILD, PP të cilat janë miratuar ose janë në process miratimi. Ministria e Drejtësisë, me hartimin e kësaj Strategjie synon përmbushjen detyrimit ligjor për udhëheqjen e një procesi gjithëpërfshirës përmes pjesëmarrjes së të gjitha institucioneve të pavarura të drejtësisë, dhe respektimin e garantimit të pavarësisë së tyre përgjatë procesit. Me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të drejtësisë tashmë të reformuar, si dhe përqasjen e sistemit të drejtësisë në Shqipëri me standardet më të mira evropiane, Ministria e Drejtësisë ka rakorduar në vijimësi punën për hartimin e kësaj Strategjie me kuadrin strategjik të të gjithë institucioneve të tjera të pavarura të drejtësisë.

2.2, Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës gjatë periudhës 2016-2020

Shqipëria ka kaluar nëpër reforma të rëndësishme në sektorin e drejtësisë. Në vitin 1998 Shqipëria ratifikoi Kushtetutën e parë post-komuniste. Në vitin 2011, Qeveria Shqiptare miratoi një strategji të sektorit të drejtësisë e cila gjeti zbatim gjatë viteve 2011-2013. Në vitin 2014, filluan përgatitjet për zbatimin e një reforme më të thellë të sektorit të drejtësisë dhe në vitin 2016, këto përpjekje u konkretizuan përmes miratimit të amendamenteve kushtetuese si dhe të gjithë kuadërit ligjor në vijim të tyre, si dhe krijimin e arkitekturës institucionale të

qeverisjes së sistemit të drejtësisë, reformatimin e institucioneve ekzistuese si dhe krijimin e institucioneve të reja të specializuara, si ato në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 773, datë 2.11.2016, miratoi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2016-2020 dhe Planin e saj të Veprimit. SND 2016-2020 mbështeste Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në BE për periudhën 2015-2020, e cila mbulonte qëllimet afatmesme dhe afatgjata të Qeverisë Shqiptare për të gjithë sektorët bazuar në një vizion kombëtar, dhe që përmbante pikat kyçe që lidheshin gjithashtu me sektorin e drejtësisë. SND 2016-2020, gjithashtu, u bashkërendua me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe planet e saj të veprimit, Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike 2015-2020, Planin Kombëtar për Integrimin në BE 2016-2020, Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, dhe strategji të tjera përkatëse sektoriale.

SND 2016-2020 u hartua duke mbajtur në konsideratë gjatë zbatimit të saj vizionin kryesor të sistemit të drejtësisë në tërësi i cili ishte: *“Shteti i së drejtës, i garantuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, mbështet konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror në vend”*. Misioni specifik i strategjisë ishte: *“Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë, në mënyrë që të sigurohet një sistem drejtësie efektiv, efikas, i pavarur dhe transparent në përputhje me praktikën më të mira evropiane”*. SND 2016-2020 përmbante 8 objektiva strategjike të nivelit të lartë, 20 objektiva specifikë dhe një numër të madh rezultatesh të pritshme të titulluara "masa".

Raporti i Vlerësimit të zbatimit të SND 2016-2020 synon të japë një panoramë të qartë të progresit të zbatimit të saj, si dhe të ndikimit të saj në sistemin e drejtësisë. Përfundimet kryesore nga ky Raport pasqyrohen si më poshtë:

- Kuadri i ri ligjor dhe institucional për gjyqësorin dhe prokurorinë është i harmonizuar me standardet evropiane duke e udhëhequr kështu Shqipërinë në një rrugë të gjatë drejt *arritjes së pavarësisë dhe përgjegjshmërisë* në këto dy fusha. Nga ana tjetër, vonesat e hasura gjatë procesit të vetting-ut do ta bëjnë të mundur që ndikimi i prekshëm pozitiv i vetting-ut për përdoruesit e gjykatave/prokurorive të vijë gradualisht gjatë një periudhe deri në 4 vjet ose më shumë nga koha e hartimit të këtij raporti.

Sa i takon *transparencës*, vlen të theksohet se ka progres në lidhje me veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), por nuk ka zhvillime të qënësishme në lidhje me aksesin në informacion nga gjykatat dhe prokuroritë, si të tilla.

Sa i përket *aksesit në drejtësi*, përpos të gjitha ndryshimeve madhore që solli në reformimin e sistemit të drejtësisë, reforma i kushtoi një rëndësi thelbësore edhe këtij komponenti me rëndësi jetike edhe në kuadër të garantimit të standardeve evropiane të ofrimit të drejtësisë dhe si kërkesë e procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Ndër të tjera, reforma në drejtësi ofroi mundësinë për krijimin e një shërbimi dhe një skeme të re efektive dhe të zbatueshme në praktikë për mënyrën sesi do të ofrohet shërbimi i ndihmës ligjore falas për qytetarët dhe veçanërisht për kategoritë në nevojë.

Në kuadër të *efikasitetit*, ndryshimet në kuadrin ligjor procedural synon që të përshpejtonin procedurat gjyqësore dhe ato të ndjekjes penale. Nuk del e qartë nga statistikat e disponueshme se janë arritur rezultatet dhe ndikimi i pritur për përdoruesit fundorë në drejtim të kohës së reduktuar të procesit. Një rritje e ndjeshme e efikasitetit ndikohet dhe nga përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit aktualisht në përdorim nga gjykatat dhe prokuroria, si dhe riorganizimi i hartës gjyqësore.

Përpos sa më sipër, procesi i vetting-ut ka një ndikim më të fortë sesa pritej në efikasitetin e organeve të sistemit gjyqësor për shkak të numrit të madh të gjyqtarëve që po shkarkohen dhe vështirësisë për t'i zëvendësuar ata për shkak të kapacitetit të kufizuar të Shkollës së Magjistraturës. Statistikat tregojnë se deri në shtator 2019, 62% e gjyqtarëve dhe 44% e prokurorëve që iu nënshtuan procedurës së rivlerësimit kalimtar u shkarkuan ose dhanë dorëheqjen përpara shkarkimit. Parashikimet tregojnë se nëse nuk ndërmerren hapa të rëndësishëm në drejtim të plotësimit të vakancave, lehtësuese, raporti i vendeve vakante në nivelet më të larta do të jetë 50% në gjyqësor dhe 33% në sistemin e prokurorisë në vitet 2023/2024.

Efekti i procesit të rivlerësimit kalimtar ka qënë veçanërisht i dukshëm në Gjykatën e Lartë² dhe Gjykatën Kushtetuese. Gjykatat e Apelit janë prekur po ashtu, duke regjistruar një mesatare prej 20% pozicionesh të lira. Në përgjithësi, gjykatat e shkallës së parë kanë pasur një numër të vogël çështjesh të mbartura. Ndërkohë, çështjet e mbartura në Gjykatat Administrative të Apelit kanë qënë më të shumta në numër në krahasim me vitet e mëparshme sa u takon apeli me administrative që kërkojnë deri në 29 muaj para se të jepet një vendim. Në gjykatat e apelit, çështjet e mbartura të natyrës civile zgjasin mesatarisht 17 muaj. Numri i çështjeve të mbartura në Gjykatën e Lartë ka qënë tepër i lartë që nga viti 2015, duke regjistruar 36 000 çështjesh që ende pritet të shqyrtohen.

Sa i përket fushës së *drejtësisë penale*, përpjekjet e reformës po e sjellin gradualisht kornizën ligjore dhe ngritjen institucionale në përputhje me standardet evropiane. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kanë filluar të operojnë në mënyrë efektive duke kontribuar kështu në rritjen e numrit të rasteve të hetuara, duke përfshirë këtu dhe gjyqtarë dhe prokurorë të shkarkuar ose të dorëhequr si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Po ashtu, ka pasur një vëmendje të shtuar në zbatimin e reformës në sistemin penitenciar, me fokus të vecantë rritjen e efikasitetit të mekanizmave të kontrollit, si edhe respektimin e të drejtave të njeriut, me qëllim shmangien e rasteve të dhunës, keqtrajtimit e diskriminimit, informimin e vazhdueshëm të të dënuarve dhe paraburgosurve. Sipas të dhënave më të fundit, sistemi i burgjeve është në nivel nënpopullimi -21%. Ky reduktim është rezultat i ngritjes së institucioneve të reja, aplikimit të dënimeve alternative, si dhe zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Për ta plotësuar kuadrin

² Vetëm dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë u konfirmuan nga organet e vetting-ut, ku njëri prej tyre është anëtar i KLGGJ-së. Të dy gjyqtarët janë konfirmuar nga organet e vetting-ut me një vendim përfundimtar. Tre gjyqtarë nga radhët e jo-magjistratëve u emëruan në Mars 2020.

e mekanizmave për zbatimin e këtyre politikave, Ministria e Drejtësisë ka miratuar ngritjen e Qendrës së Parandalimit të Krimit të të Miturve si institucioni i parë i këtij lloji në vend, e cila pritet të bëhet funksionale në vitin 2021. Në vazhden e nismave për përmirësimin e drejtësisë penale, Ministria e Drejtësisë ka nisur një proces gjithëpërfshirës për hartimin e një Kodi të ri Penal bashkëkohor, që i përgjigjet nevojave të drejtësisë penale aktualisht në Shqipëri.

Në lidhje me *sektorin e teknologjisë së informacionit*, progresi brenda sistemit gjyqësor në shkurt 2020 ishte ende në një fazë fillestare, ndërsa progresi në sistemin e Prokurorisë ishte në masën e realizimit 50%, ndaj rezultatet pritet të finalizohen gjatë vitit 2021. Këto rezultate janë modeste dhe përmirësime domethënëse do të regjistrohen vetëm me zhvillimin e sistemeve krejtësisht të reja të menaxhimit të çështjeve, të cilat priten rreth vitit 2023 ose 2024, duke pasur si qëllim funksionet e regjistrimit elektronik, i cili është një parakusht rritjen e efikasitetit në sistemin e drejtësisë.

Së fundmi, po arrihen rezultate konkrete në lidhje me *profesionet e lira ligjore*. Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për plotësimin e kuadrit nënligjor të funksionimit të profesionit të noterit, avokatit, ndërmjetësit dhe përmbartuesit privat, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve nga aktorët në këtë fushë. Kuadri i inspektimit, përfshirë metodologjitë përkatëse, është plotësuar me metodologji të vlerësimit të riskut. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë ka ende nevojë të forcojë kapacitetet për të kryer inspektime në mënyrë efektive në lidhje me profesionet e lira ligjore.

Rekomandimet përmbledhëse për fazën e ardhshme të zbatimit të SND 2021-2015 sipas fushës tematike të shprehura në Raportin e vlerësimit janë përfshirë në kapitujt përkatës më poshtë.

2.3 Koncepti për fazën e strategjisë së re

Koncepti i strategjisë

Raporti i vlerësimit nxorri në pah rekomandimet e mëposhtme të përgjithshme, të nevojshme për hartimin e SND 2021-2025:

- Një përqendrim më i madh në qëllimet e politikës së strategjisë, p.sh. 3-5 qëllime politike me numër të kufizuar të objektivave specifike për secilin (strategjia e vjetër: 8 qëllime politike, 20 objektiva);
- SND-ja duhet të jetë strategji ombrellë që adreson vetëm çështje kyçe, të mbështetura nga strategji institucionale që mbulojnë fusha më të gjera dhe më pak çështje strategjike;
- DUhet inkuadruar “teoria e ndryshimit” në periudha të ndryshme të zbatimit të Strategjisë;
- Të garantohet koherencë: aktivitetet e përcaktuara duhet të jenë kushte të nevojshme dhe të mjaftueshme për të arritur objektivat specifike;
- Nevojë për hartimin e planeve strategjike të Shërbimit të Provës, Drejtorisë së Ndihmës Ligjore Falas (DNLF), Prokurorisë së Përgjithshme (PP), Inspektorin e Drejtësisë së Lartë (ILD). Strategjia e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGj) do të hartohet me

mbështetjen e JFA-së. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) duhet të miratojë projekt strategjinë që tashmë është hartuar;

- Dokumenti i strategjisë duhet të jetë i thjeshtë për tu lexuar dhe i ilustruar mirë, duke përfshirë gjithashtu një strategji komunikimi solide
- Sistemi i monitorimit duhet të forcohet duke ndërvepruar me të gjitha institucionet zbatuese të planit të veprimit, si dhe gjetjet nga analiza të përdoren gjatë procesit të rishikimit të planeve të veprimit;
- Nevoja për ta vizualizuar procesin e reformës dhe fuqizimit të sistemit të drejtësisë si një progres gradual drejt standardeve evropiane.

Arritja e standardeve evropiane përmes reformave në faza

Aderimi në Bashkimin Evropian është një nga pikësynimet dhe prioritetet kryesore të Shqipërisë. Të gjitha institucionet shqiptare vijnë punën për të përmbushur kriteret e nevojshme dhe për të garantuar respektimin e parimeve thelbësore në fushën e drejtësisë, si themele për ndërtimin e një shteti të së drejtës. Në SND 2021-2025 masat e parashikuara do të hartohen duke mbajtur në konsideratë *acquis* e Bashkimit Evropian për kapitullin 23, e konkretisht nën-fushën e gjyqësorit, si dhe rekomandimet e raportit të Progresit të Komisionit Evropian. Rrjedhimisht, zbatimi i masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë do të ecë paralelisht me agjendën e integritetit në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë është hartuar në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për sa i përket përmbushjes së 5 prioritetëve lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider për prioritetin 2 “Sistemi Gjyqësor”, prioritetin 3 “Lufta kundër korrupsionit”, si dhe institucion kontribues për prioritetin 5 “Mbrojtja e të drejtave të njeriut”. Ministria e Drejtësisë ka ndjekur dhe koordinuar punën me të gjithë aktorët lidhur me adresimin e rekomandimeve të progres raportit të Komisionit Evropian për vitin 2020.

Sikurse është përmendur edhe më lartë, reforma në drejtësi do të kalojë nëpër tre faza strategjike, ku faza aktuale ofron bazën ligjore dhe institucionale, faza tjetër (2021-2025) do të mbulojë konsolidimin ligjor dhe institucional, dhe një fazë përfundimtare duke filluar nga viti 2026 do të mbulojë zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të ofruara sipas standardeve më të mira evropiane.

Strategjia gjithëpërfshirëse


Për shkak të ekzistencës së disa institucioneve të pavarura të drejtësisë, strategjia propozohet të ndërtohet mbi planet strategjike të institucioneve individuale me strategjinë sektoriale që është një dokument strategjik ombrellë që mbulon qëllimet dhe objektivat kryesore të politikës strategjike, ndërsa strategjitë institucionale do të adresojnë detajet specifike. Disa elementë të strategjive institucionale do të përfshihen në kuadrin e përgjithshëm të strategjisë, të tjerët - ato me më pak rëndësi të përgjithshme - do të pasqyrohen vetëm në strategjitë institucionale. Reforma quhet ndërsektoriale, pjesërisht sepse mbulon praktikisht të gjithë sektorin e drejtësisë, dhe pjesërisht sepse ka një numër programesh dhe elementesh ndërsektoriale.

Vazhdimi i reformës me një fokus më të qartë

Gjetjet e konstatuara gjatë zbatimit të SND2016-2020 për shkak të numrit të lartë të qëllimeve dhe objektivave, ka qenë e vështirë të menaxhohen, monitorohen, si dhe të komunikohet progresi dhe arritjet në raport me ofrimin e shërbimeve ndaj publikut. Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të kësaj strategjie 2021-2025 synon të përfshijë në planin e veprimit ata komponentë, puna për implementimin e të cilëve do të vazhdojë edhe pse mund të jenë shkrirë brenda të njëjtit qëllim politik. Në hartimin e strategjisë 2021-2025, çështjet që mund të trajtohen brenda planeve institucionale të institucioneve të sektorit të drejtësisë dhe që nuk janë të një natyre ndërsektoriale janë lënë jashtë strategjisë aktuale të përgjithshme.

Figura më poshtë tregon se si disa nga 8 "qëllimet" kryesore të fazës së vazhdueshme të SND 2016-2020 janë bashkuar në 4 "Qëllime Politike" të SND 2021-2025.

Figura 2. Ilustrimi se si 8 qëllimet në fazën aktuale të strategjisë SND 2016-2020 janë bashkuar në 4 qëllime politike në fazën tjetër, SND 2021-2025:



Strategjitë institucionale

Bazuar në nevojat institucionale dhe gjetjet e raportit të vlerësimit të zbatimit të SND 2016-2020, u arrit në konkluzionin se institucionet e përfshira në SND dhe institucionet e varësisë duhet të hartonin planet e tyre strategjike. Bazuar në këtë qasje, u konkludua se ekspertë nga Misioni Euralius V do të asistojnë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, Drejtorinë e Shërbimit të Provës dhe Prokurorinë e Përgjithshme për të hartuar dhe miratuar planet e tyre strategjike. Ndërsa “Justice for All” do të vijonte punën me asistencën ndaj KLGJ-së për të zhvilluar strategjinë e tyre ekzistuese 1-2 vjeçare, në një strategji afatmesme. Puna për strategjinë e KLGJ-së, assistuar nga JFA pritet të përfundojë në fillim të vitit 2021.

Bazuar në sa më sipër, puna për strategjitë e DNJF-së dhe Shërbimit të Provës përfundoi në korrik të vitit 2020 për strategjinë kryesore, ndërsa planet e veprimit dhe buxhetimi përfunduan në shtator 2020. Për PP puna pritet të mbarojë në vitin 2021. ILD ka zhvilluar gjithashtu planin e vet. Figurat 4 dhe 5 në kapitullin 3 ilustrojnë lidhjen midis planeve institucionale dhe SNDII (plani ombrellë).

Terminologjia

Gjatë hartimit dhe zbatimit të SND 2016-2020 është mbajtur në konsideratë dhe përdorur terminologjia që diktohet nga VKM nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”, Bazuar në logjikën e ndërhyrjes terminologjia që do të përdoret për emërtimin e komponentëve të SND 2021-2025 do të jetë si vijon: Vizioni, Qëllimi politik, Objektivi specifik, Rezultatet e pritshme, Masat prioritare (vetëm në planet e veprimit, ku mund të përfshihen edhe aktivitete specifike)

Në mbështetje të këtij procesi, propozohen qëllimet kyçe të mëposhtme dhe përmbledhja e fazës (fazave) të ardhshme të strategjisë:

Metodologjia e “**Teoria e ndryshimit**” e zbatuar në rastin e SND, mund të përshkruhet si më poshtë: SND ka synimin kryesor garantimin e vazhdimësisë së zbatimit të reformës në drejtësi dhe është hartuar duke pasur si qëllim zhvillimin e sistemit të drejtësisë gjatë 10 deri në 15 vitet e ardhme, e ndarë në tri faza të ndryshme si më poshtë vijon:


Faza I: Përmes **SND 2016-2020** u hodhën bazat ligjore dhe institucionale të reformës në drejtësi, përfshirë ndryshimet kushtetuese, ndryshime të tjera legjislative në të gjithë sektorin duke e sjellë kornizën ligjore në standardet evropiane dhe krijimin e institucioneve të reja në përputhje me modelet evropiane, përfshirë këtu dhe një proces rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Faza II: Kjo fazë mbulon vitet 2021-2025, konsolidon ndryshimet institucionale, përfshin praktikat moderne evropiane në drejtësinë penale, përmirëson infrastrukturen e sistemit të drejtësisë dhe ofron zgjidhje për IT-në, duke përfshirë këtu zgjidhjet inovative elektronike që mbështesin një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë.

Faza III: Kjo fazë është e konsideruar si faza e fundit e reformave madhore³: 4-5 vite pas fazës II, eliminon *backlog*-un dhe rrit cilësinë e shërbimeve / ofrimit të drejtësisë në të njëjtat nivele si edhe në vendet e BE-së.

Duhet të theksohet se konsolidimi i institucioneve të qeverisjes, konsolidimi i punës së ShM dhe përmirësimi i rregulloreve që lidhen me arsimin universitar në drejtësi, si dhe ndërtimi i kapaciteteve të MD në një masë të madhe do të ketë përfunduar në fund të vitit 2025. Prandaj, faza tre e SND që mbulon një periudhë 4-5 vjeçare nga 2026 e në vijim do të përqendrohet në përmirësimet në ofrimin e shërbimeve nga gjykatat, në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga institucionet e drejtësisë penale, përmirësimet në ofrimin e shërbimeve nga disa prej institucioneve të tjera vartëse dhe drejtoritë e MD dhe investimet e lidhura me infrastrukturën.

Procesi i ndryshimit ilustron në figurën e mëposhtme:



3 Vizioni i Strategjisë

3.1 Vizioni

³ Refromat mund të vijnë pas përfundimit të fazës III, por është parashikuar që do të jenë të lidhura me përmirësimet graduale në nivel institucional dhe jo reforma të gjera ndërsektoriale.

Vizioni i programit të Sektorit: Sistem i drejtësisë i pavarur, i përgjegjshëm, i arritshëm, transparent dhe eficient që mbrohet të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane.

- **Qëllimi i politikës 1:** Funkcionimi profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.
- **Qëllimi i politikës 2:** Fuqizimi i transparencës, kompetencës, aksesit dhe efikasitetit të gjyqësorit në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe standardet evropiane.
- **Qëllimi i politikës 3:** Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, duke garantuar risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.
- **Qëllimi i politikës 4:** Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit

Zbatimi i qëllimit të politikave do të arrihet përmes Objektivave Specifik, dhe secili Objektiv Specifik do të realizohet përmes masave dhe aktiviteteve që do të zbatohen nga institucionet duke pasur në konsideratë rezultatet e pritshme nga ky zbatim. Struktura e përgjithshme e kuadrit të politikave të bazuar në vizion ilustron në figurën 4.

Figura 4






Figura 5

Logjika e plotë e ndërhyrjes me 4 Qëllime Politikash (QP), 17 Objektiva specifike dhe lidhjet e tyre tregohen në figurën më poshtë. Secili nga objektivat specifike (OS) përfaqësojnë një plan veprimi ose një strategji institucionale dhe një plan veprimi (psh. Shërbimi i Provës)



Mënyra se si SND 2021-2025 e konceptuar si një strategji ombrelle lidhet me planet institucionale tregohet në figurën Nr. , duke përdorur për qëllime ilustrimi Qëllimin e Politikës 3.

Figura 6



3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultateve

Objektivi Specifik	Treguesi i rezultateve të propozuara
Objektivi Specifik 1.1: Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të zbatohet dhe finalizohet në mënyrë efektive siç parashikohet nga Kushtetuta dhe ligji	1.1: % e gjyqtarëve/prokurorëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit (vetting-ut) ose që kanë dalë në pension vullnetarisht (vlera të ndara për gjyqtarët dhe prokurorët)
Objektivi Specifik 1.2: Legjislacioni i reformës në drejtësi përditësohet bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kuadrin ligjor të përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin dhe koordinimin.	Arritjet e procesit në planin e veprimit
Objektivi Specifik 1.3: Konsolidimi dhe fuqizimi i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (kryesisht krijimi e zhvillimi i kapaciteteve dhe infrastruktura), dhe ofrimi i shërbimeve të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përmbushje të standardeve të kërkuara, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse ushtrohen në përputhje me kuadrin ligjor, si dhe emërimet, ngritjet në detyrë dhe transferimet janë të besueshme dhe të bazuara në merita.	Arritjet e procesit në planin e veprimit 1.3.1: % e gjyqtarëve që janë emëruar/ngritur në detyrë, transferuar për arsye të ndryshme nga aftësitë dhe përvoja në dy vitet e fundit. ⁴ 1.3.2: E njëjtë me 1.1.1., vetëm se ky tregues zbatohet për prokurorët 1.3.3. A: % e procedurave disiplinore të nisura ndaj gjyqtarëve ose prokurorëve që rezultojnë me masa disiplinore (duke përfshirë marrëveshjet për pranimin e fajësisë) ⁵ 1.3.3: B Treguesi për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura për për çështjet disiplinore pranë ILGJ
Objektivi Specifik 2.1: Rregullimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej kompetencën, aksesin, transparencën dhe efikasitetin	Arritjet e procesit parashikohen në planin e veprimit
Objektivi Specifik 2.2: Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj tërësor, në mënyrë transparente dhe efektive	Arritjet e procesit parashikohen në planin e veprimit
Objektivi Specifik 2.3: Sistem efikas dhe kompetent i trajnimit nëpërmjet Shkollës së	2.3 Numri i ditëve të trajnimit vazhdues për çdo gjyqtar / prokuror.

⁴ Indikatori 1 nga pasaporta aktuale e indikatorëve

⁵ Indikatori 5 nga pasaporta aktuale e indikatorëve

Magjistraturës i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë të trajnuar për gjyqësorin dhe prokurorinë në Shqipëri.	
Objektivi Specifik 2.4: Sigurimi i funksionimit efektiv të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL, dhe sigurimi i dhënies të drejtësisë së përmirësuar në përputhje me kompetencat në rritje të aksesit dhe transparencës në gjyqësor.	2.4.A: Treguesi për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura për sistemin gjyqësor (vlera të ndara për GjL, apelin dhe për gjykatat e shkallës së parë, përfshirë çështjet penale, civile dhe administrative) 2.4.B: % e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështjeje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe apelin, vetëm juridiksioni i zakonshëm)⁶ 2.4.C: % e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështjeje civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për çdo shkallë)⁷ 2.4.D: % e çështjeve civile, për të cilat është marrë një vendim në jo më shumë se tre seanca (vetëm në shkallën e parë)⁸ 2.4.E: Reduktimi i çështjeve të prapambetura në vlerësimin e performancës vjetore të gjyqtarëve 2.4.F: Të dhënat për plotësimin e kërkesave të përdoruesit 2.4.G: % e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është i disponueshëm dhe i përditësuar në internet.⁹
Objektivi Specifik 2.5: Aksesit efektiv në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.	2.5.A: % e aplikantëve të kualifikuar që marrin ndihmë juridike parësore 2.5.B: % e aplikantëve të kualifikuar që marrin ndihmë juridike dytësore¹⁰
Objektivi Specifik 3.1: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të zinxhirit të institucioneve të drejtësisë dhe të bazuar mbi parandalimin, ri-socializimin, ri-integrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar kështu qasjen ekzistuese me natyrë ndëshkuese.	3.1.A: Numri i krimeve të kallëzuara në polici, veçanërisht lloji specifik i krimeve që programi parandalues synon të zvogëlojë 3.1.B: Numri i incidenteve të viktimizimit të raportuara nga të anketuarit në një sondazh për viktimizimin.

⁶ Indikator 2 i pasaportës aktuale të indikatorëve

⁷ Indikator 3 i pasaportës aktuale të indikatorëve

⁸ Indikator 4 i pasaportës aktuale të indikatorëve

⁹ Indikator 7 i pasaportës aktuale të indikatorëve

¹⁰ Indikator 8 i pasaportës aktuale të indikatorëve

	3.1.C: % e çështjeve të paraburgimit që përfshijnë krime jo të rënda
Objektivi Specifik 3.2: Një sistem efikas dhe proaktiv për ndjekjen penale që funksionon sipas standardeve evropiane. Një strategji specifike do të hartohet e miratohet bazuar në draftin e strategjisë të paraqitur nga PP në Mars 2020 (e cila do të përfshijë riorganizimin/specializimin, pajisjet dhe investimet në godina në përputhje me hartën e re gjyqësore).	Indikatorët do të zhvillohen me PP
Objektivi Specifik 3.3: Përmirësimi i drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të fëmijës.	3.3.A: % e uljes së të miturve në paraburgim ¹¹ 3.3.B: Numri i fëmijëve dhe prindërve të përfshirë në programe ri-integruese 3.3.C: % e çështjeve me fëmijë të mitur të shqyrtuar nga prokuroria, çështje në të cilat janë zbatuar masat konvertuese dhe dënimet alternative në vend të dënimit me burgim.
Objektivi Specifik 3.4: Një shërbim prove efektiv që përdor standardet operationale, metodologjitë e mbikqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet ri-socializimin, ri-integrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së dhe është pranuar nga gjykatat dhe prokuroria si një alternativë e mirë ndaj burgimit.	3.4.A: % e vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet të cilat përfshijnë dënime alternative ¹² 3.4.B: Ndryshimi i mbështetjes në radhët e grupeve të interesit të sektorit, duke përfshirë OSHC-të për dënimet pa burgim 3.4.C: Përqindja e të gjithë autorëve të veprave penale të dënuar me shërbim prove, të cilët e kryejnë me sukses periudhën e shërbimit të provës;
Objektivi Specifik 3.5: Zhvillimi i një sistemi efikas burgjesh bazuar në strategjinë për reformën e burgjeve në vazhdim, e cila siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane individuale për zhvillimin e çështjeve.	3.5A: Raporti i të burgosurve me shtretërit zyrtarë, p.sh. si masë ndaj mbipopullimit në burg; 3.5B: Numri mesatar i të burgosurve për çdo roje në një institucion; 3.5C: Numri i arratisjeve; 3.5D: Numri i autorëve të veprave penale që vdesin kur janë në paraburgim në një periudhë të caktuar kohe; 3.5E: Numri i ankesave të regjistruara nga Avokati i Popullit ose nga organizatat për të drejtat e njeriut në lidhje me sjelljen e papërshtatshme të zyrtarëve të burgut;

¹¹ Kjo përfshin numrin e përgjithshëm të të miturve që kanë kaluar çfarëdolloj kohe në paraburgim gjatë vitit kalendarik.

¹² Sipas nenit 59 të kodit penal (pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në shërbimin e provës), Neni 59a i Kodit Penal (qëndrimi në shtëpi) dhe Neni 63 i Kodit Penal (shërbimi në interes publik).

Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i plotë i Sistemit të integruar të <i>e-drejtësisë</i> me një identifikues të unifikuar, sistemeve të përditësuara të menaxhimit të çështjeve, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të tre fushat ligjore (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare (duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve institucionale, pajisjet, programet kompjuterike).	4.1.A: % e çështjeve gjyqësore të paraqitura përmes regjistrimit elektronik dhe të trajtuara nga gjykatat në mënyrë elektronike 4.1.B: % e çështjeve të ndjekjes penale të trajtuara nga prokuroria në mënyrë elektronike dhe të paraqitura përmes regjistrimit elektronik
Objektivi Specifik 4.2: Koordinimi sektorial, menaxhimi i performancës dhe përmirësimi i sistemeve të komunikimit duke siguruar angazhime më të mëdha nga të gjitha institucionet për një koordinim efektiv të sektorit dhe komunikim të rrjedhshëm.	4.2 Sondazhi i perceptimit ndërmjet përfaqësuesve të mediave në lidhje me cilësinë e transparencës së sektorit dhe komunikimin institucional
Objektivi Specifik 4.3: Zhvillimi i kapaciteteve të MD-së dhe zhvillimi i burimeve, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e vartësisë, p.sh. nëpërmjet mbështetjes specifike të manaxhimit/zhvillimit të kapaciteteve për institucionet e përzgjedhura (p.sh. Përmbaruesit)	4.3.A: % e inspektimeve të profesioneve ligjore të lira nga ana e MD-së, të zbatuar në fakt, në krahasim me kërkesat 4.3.B: % e inspektimeve të kërkuara ligjërisht për noterët të kryera nga MD
Objektivi Specifik 4.4: Përditësimi i kuadrit ligjor dhe zhvillimi i kapaciteteve të MD për të siguruar përfshirjen në bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar dhe përgatitjen e Shqipërisë për hyrjen në BE nëpërmjet harmonizimit të legjislacionit shqiptar me <i>acquis</i> të BE-së dhe akteve të tjera të integritimit me BE-në dhe shtetet anëtare të saj në fushën e Drejtësisë	4.4.A: Kohëzgjatja faktike (ditë ose muaj) e procedurave kryesore krahasuar me kohëzgjatjen e synuar 4.4.B: Numri i akteve që janë harmonizuar.

4 Qëllimi i Politikës 1– Qeverisja, pavarësia dhe llogaridhënia në sistemin e drejtësisë

Raporti i Vleresimit të zbatimit të SND 2016-2020 tregoi se institucionet e reja të qeverisjes janë krijuar dhe po funksionojnë edhe pse mbetet ende punë për konsolidimin e funksionimit të tyre. Në këtë kuadër, pritet që funksionaliteti i plotë do të duhet të zhvillohet dhe konsolidohet në periudhën e ardhshme të strategjisë. Ecuria e punës së tyre dhe të procesit të reformës mund të nxjerrë në pah nevojën për rishikim të legjislacionit në lidhje me institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Sa i përket procesit të Vetting-ut, deri në fund të vitit 2019, vetëm afërsisht 30% e punës ishte përfunduar dhe, gjatë krizës së virusit korona, progresi ka qenë më i ngadaltë. Prandaj ekziston një rrezik i lartë që procesi të mos përfundojë brenda mandatit kushtetues të KPK në fund të vitit 2022, kështu që do të duhet të zhvillohet një mekanizëm i ri gjatë fazës së Strategjisë së re (2021-2025) për të përfunduar procesin në një mënyrë bindëse duke pasur parasysh ndër magjistratët në detyrë, që ende janë në listën e pritjes së procesit të vetting-ut.

Referuar gjetjeve të Raportit të vlerësimit dhe pas konsultimit me ekspertë dhe aktorë të interesuar, më poshtë paraqiten tiparet kryesore të fazës tjetër të SND në fushën e qeverisjes së drejtësisë, pavarësisë dhe transparencës të cilat janë përshkruar duke përfshirë Qëllimin e Politikës, Objektivat Specifike dhe rezultatet e pritura¹³:

Logjika e ndërhyrjes	Institucioni(et) përgjegjës(e)
Qëllimi i Politikës 1: Institucionet e qeverisjes në drejtësi punojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe standardet evropiane, dhe këto institucione janë të pavarura dhe punojnë me profesionalizëm, efikasitet dhe ruajnë standardet e llogaridhënies.	
➤ Objektivi Specifik 1.1: Zbatimi dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar në mënyrë efektive dhe efikase siç parashikohet nga Kushtetuta dhe ligji	KPK
• Rezultati 1.1.1: Procesi i vetting-ut të ketë përfunduar deri në vitin 2024 për të tre kategoritë e subjekteve të rivlerësimit (gjyqtarë, prokurorë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë).	KPK
• Rezultati 1.1.2: Rregullat perkatëse, praktikat e mira, njohuritë, kapacitetet dhe mësimet e marra transferohen siç duhet në institucionet perkatëse të qeverisjes së sistemit të drejtësisë për vlerësime të mëtejshme të qëndrueshme dhe të besueshme për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë.	KPK
➤ Objektivi Specifik 1.2: Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke	Institucionet e qeverisjes në

¹³ Për shkak të shumë intuitave të përfshira në program, përfshirjes së institucioneve të pavarura dhe numrit të madh të masave prioritare të mbuluara nga secili objektiv specifik, tabela e mësipërme përfshin deri në rezultate në logjikën e ndërhyrjes. Masat e përparësisë përfshihen vetëm në planet e veprimit të përfshira në planet institucionale dhe të ngarkuara në IPSIS:

përfshirë, por pa u kufizuar në, rregullat e përditësuara për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.	drejtësi, MD, Kuvendi
Rezultati 1.2.1 - Struktura e qeverisjes së gjyqësorit (KLGJ) / legjislacioni i rishikuar/ndryshuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, rregulloret e brendshme.	KLGJ, MD, Kuvendi
Rezultati 1.2.2 - Struktura e qeverisjes së Prokurorisë (KLP) / legjislacioni i rishikuar/ndryshuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, rregulloret e brendshme.	KLGJ, MD, Kuvendi
Rezultati 1.2.3 - Strukturat e llogaridhënies (ILD, KLGJ dhe KLP) / legjislacioni i rishikuar/ndryshuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, rregulloret e brendshme.	KLGJ, KLP, ILD, MD, Kuvendi
➤ Objektivi Specifik 1.3: Fuqizimi dhe konsolidimi institucional i institucioneve të qeverisjes në drejtësi (kryesisht krijimi e zhvillimi i kapaciteteve dhe pajisjet) të kryejnë aktivitetin me pavarësi, eficiencë dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i përgjithshëm i shërbimit të institucioneve të qeverisjes përmbush rregullat dhe standardet përkatëse, dhe rolet dhe përgjegjësitë përkatëse kryhen në mënyrën e duhur në përputhje me standardet Evropiane, dhe emërimet, promovimet dhe transferimet, verifikimet, procedimet disiplinore dhe inspektimet bazohen në meritë dhe janë të besueshme.	KLGJ, KLP, ILD
Rezultati 1.3.1 - Kapacitetet (duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin) dhe burimet (financiare, pajisje dhe infrastrukturë) të KLGJ-së janë të përshtatshme për të zbatuar aktivitetet e saj. KLGJ emëron, promovon dhe transferon numrin e kërkuar të gjyqtarëve dhe/ose të keshilltarëve ligjorë sipas rregullave dhe standardeve të kërkuara dhe të miratuara (Shënim: Ky rezultat mund të bashkohet me Objektivin Specifik 2.3 për shkak të karakterit të integruar të pushtetit gjyqësor).	KLGJ
Rezultati 1.3.2 - Kapacitetet (duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin) dhe burimet (financiare, pajisje dhe infrastrukturë) të KLP-së janë të përshtatshme për të zbatuar aktivitetet e saj si dhe e KLP emëron, promovon dhe transferon numrin e kërkuar të gjyqtarëve dhe/ose të keshilltarëve ligjorë sipas rregullave dhe standardeve të kërkuara dhe të miratuara	KLP
Rezultati 1.3.3 - Kapacitetet (duke përfshirë proceset, aftësitë dhe menaxhimin) dhe burimet (financiare, pajisje dhe infrastrukturë) e ILD-së janë forcuar dhe konsoliduar dhe ky institucion ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur, efikase dhe profesionale, duke zhvilluar procesin e verifikimit, hetimit disiplinor dhe inpektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare. Këto aktivitete do të kryhen siç do të shihen të nevojshme për funksionimin e duhur të gjyqësorit dhe të prokurorisë, dhe në përputhje me kërkesat ligjore, kuadrin rregullator dhe standardet e kërkuara.	ILD

Masat e përparësisë dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet e specifikuara janë përshkruar në planet e veprimit të ngarkuara në IPSIS dhe / ose të publikuara në faqet e internetit të institucioneve (p.sh. institucionet e pavarura).

5 Qëllimi I Politikës 2 – Gjyqësori: Akses, Efienca dhe Transparenca

Nga analiza e zbatimit të SND 2016-2020 në lidhje me Gjyqësorin, puna kryesore e pazgjidhur është zbutja e ndikimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, konsolidimi i sigurt i institucioneve të reja, rritja e efikasitetit (p.sh. masat me natyrë procedurale në sistemin gjyqësor), adresimi i çështjeve të transparencës dhe aksesit në drejtësi (p.sh. me mekanizma shtesë të zgjidhjes alternative, rregullim të tarifave gjyqësore, etj.), dhe sigurimi i një qasjeje më të fokusuar në ofrimin e shërbimeve përmes vëmendjes ndaj kohës së procesit dhe reduktimit të *backlog*-ut.” Bazuar në këto gjetje dhe në konsultim me aktorët e sektorit të drejtësisë si dhe ekspertët në këtë fushë, përmbajtja e mëposhtme e strategjisë është propozuar për fushën e aksesit, transparencës dhe efikasitetit të gjyqësorit:

Logjika e ndërhyrjes	Institucioni(et) përgjegjës(e)
➤ Qëllimi i Politikës 2: Rritja e transparencës, aftësisë profesionale, aksesueshmërisë dhe efiençës të gjyqësorit në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet evropiane.	
➤ Objektivi Specifik 2.1: Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efiençën	MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 2.1.1 Rishikimi i kodeve të procedurave civile, penale dhe ligjin për gjykatën administrative dhe kodi i familjes dhe i pjesëve të tjera të rëndësishme të çështjeve të legjislacionit shqiptar për të rritur transparencën dhe efikasitetin dhe për të siguruar aksesueshmërinë, duke u përqëndruar në çështjet që kanë themel, duke dekurajuar sa më shumë që të jetë e mundur paraqitjen e çështjeve të pathemelta.	MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 2.1.2 Ndryshim i dispozitave ligjore në lidhje me sistemin gjyqësor për të lejuar organizimin kompetent, transparent dhe efikas të proceseve gjyqësore, dhe për të tërhequr staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Përfshirja e legjislacionit specifik për të siguruar transparencën dhe efikasitetin e proceseve të administratës gjyqësore dhe menaxhimin efikas të performancës cilësore të stafit të administratës gjyqësore dhe zotërimi i financimit të mjaftueshëm për çdo rikuperim kostosh.	MD, KLGJ, MD, Kuvendi
➤ Objektivi Specifik 2.2: Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj tërësor, në mënyrë transparente dhe efektive	GJK, MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 2.2.1 – Hulumtim i thelluar i situatës dhe, nëse është e nevojshme, rishikim i legjislacionit për të siguruar procese transparente, efektive në GJK dhe menaxhim të performancës cilësore të stafit të administratës së GJK-së.	GJK, MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 2.2.2 – Hulumtim i thelluar i situatës dhe, nëse është e nevojshme, rishikim i dispozitave ligjore përkatëse për të tërhequr staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar dhe akordimi i burimeve mbështetëse më të mira për GJK-në dhe garantimi i financimit të mjaftueshëm.	GJK, MD, QSH, Kuvendi

Rezultati 2.2.3 - Hartimi dhe zbatimi i një plani për zhvillimin e kapaciteteve, duke përfshirë strategjinë e transparencës dhe komunikimit që siguron një komunikim efektiv dhe efikas dhe transparencë të plotë për përdoruesit e GJK-së dhe grupet e tjera të interesit.	GJK, MD, MFE
➤ Objektivi Specifik 2.3: Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistrateve dhe këshilltarëve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.	KLJG
Rezultati 2.3.1 – Përmirësimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave të Programit të Trajnimit Vazhdues	SHM
Rezultati 2.3.2 – Transformimi gradual i SHM edhe në një qendër informacioni dhe burimore në lidhje me të drejtën e BE-së dhe legjislacionin evropian për të drejtat e njeriut, si dhe rritja e kapaciteteve për kërkime dhe publikime.	SHM, QSH
➤ Objektivi Specifik 2.4: Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët. (Shënim: Aktivitetet që kanë të bëjnë me KLJG si autoritet qeverisës në drejtësi janë integruar në këtë Objektiv Specifik për shkak të karakterit të integruar të sistemit gjyqësor. Rezultatet e pritshme të poshtëshënuar reflektojnë qëllimet strategjike të shkruara në strategjinë e KLJG)	
Rezultati 2.4.1 : Përshpejtimi i Reformës në Gjyqësor, përfshirë infrastrukturën gjyqësore dhe plotësimin me personel sa me shpejt që është e mundur, duke ruajtur fokusin në cilësinë e shërbimit. Kjo fushë përfshin sigurimin e funksionimit optimal të Gjykatës së Lartë dhe GJKKO.	KLJG
Rezultati 2.4.2: Vendosja dhe Zbatimi i Standardeve për Ekselencë në sistemin gjyqësor për zbatimin e praktikave më të mira të manaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë nivelet e gjyqësorit, duke u fokusuar në standarde.	SHM
Rezultati 2.4.3: Dhënia e Shërbimeve me Efikasitet dhe rritja e cilësisë së punës së gjykatave. Përmirësimi në dhënien e shërbimeve të drejtësisë nëpërmjet përdorimit të zgjeruar të TI, inovacionit dhe fuqizimit të strukturës dhe sistemeve teknologjike që garantojnë koherencë institucionale, efikasitet dhe efektivitet.	KLJG
Rezultati 2.4.4: Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme të KLJG. Përkufizim i qartë i rolit të KLJG dhe i administratës së tij, si dhe përcaktimi i përparësive për fuqizimin institucional, ndërtimin e kapaciteteve, dhe qëndrueshmërinë, përfshirë kërkimin e burimeve të përshtatshme buxhetore.	GJL, KLJG
Rezultati 2.4.5: Krijimi i Komunikimit dhe Koordinimit Efektiv të Jashtëm. Përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve të tij, institucioneve të pavarura, si ILD, dhe publikut duke zhvilluar dhe zbatuar një strategji komunikimi të qartë.	ILD

➤ Objektivi Specifik 2.5: Aksesit efikas në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme	
Rezultati 2.5.1 – Operatorët e ndihmës juridike falas janë të disponueshëm në të gjithë vendin dhe ndihma juridike falas zhvillohet plotësisht (zhvillimi institucional dhe i kapaciteteve, duke përfshirë fuqizimin e menaxhimit të DNJF-së dhe ofruesëve NJF-së, si dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme dhe lehtësirave/objekteve (DNJF dhe qendrat e ndihmës juridike) dhe pajisjeve të duhura.	DNJF, MD, MF
Rezultati 2.5.2 - Përmirësohen mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) duke zhvendosur kompetencat përkatëse nga gjykatat në organet e tjera shtetërore (ndryshimet ligjore, zhvillimi institucional, personeli dhe zhvillimi i kapaciteteve, dhe objektet).	KM, MD, Kuvendi
Rezultati 2.5.3 – Rishikimi i sistemit të tarifave gjyqësore (rritja e tarifave dhe përjashtimet e tarifave) në mënyrë periodike për të maksimizuar aksesin në gjykatë dhe për të siguruar akses për çështje të themelta dhe vendosja e sistemeve të rikuperimit të kostove për palët që përdorin sistemet e gjykatave, kudo që palët kanë mundësi të paguajnë për kosto të tilla.	KLGJ, MD, MFE, QSH

6 Qëllimi i Politikës 3 – Një Sistem i Drejtësisë Penale i cili mbështetet në risocializim, riintegrim dhe rehabilitimin, si dhe respekton të drejtat e njeriut

Drejtësia penale ishte pjesë e fazës së Strategjisë 2016-2020. Në këtë kuadër, MD ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të hartimit dhe zbatimit të legjislacionit të ri për sistemin penitenciar dhe, si dhe ka krijuar baza solide për konsolidimin e drejtësisë penale për të mitur. Megjithatë, ka ende nevojë për përmirësim të ndjeshëm të ofrimit të shërbimeve në përputhje me standardet evropiane. Në këtë kuadër, nga raporti i vlerësimit të Snd 2021-2025 ka lindur si domosdoshmëri përdorja e një qasjeje të integruar të zinxhirit institucional i cili ka dhënë rezultate të mira me drejtësinë për të mitur, bazuar në parimet e drejtësisë restauruese.

Në këtë fazë të do marrë vëmendje të shtuar hartimi i një plani veprimi të të dedikuar për Shërbimin e Provës. Parandalimi i krimit gjithashtu duhet të analizohet dhe të përfshihet në një fazë të re dhe duhet të bëhen më shumë kërkime mbi modelet e krimit dhe arsyet pse raportimi i krimit është relativisht i ulët në Shqipëri. Në këtë kuadër, do të vlerësohet dhe nisma për hartimin e Kodit të ri Penal.

Përsa i përket planifikimit lidhur me shërbimin e burgjeve i cili mbulon dhe periudhën 2019-22, lind nevoja e shtrirjes së këtij plani veprimi deri në vitin 2025, i cili po zhvillohet në kuadër të kësaj Strategjie. Zhvillimi i një politike parandalimi të krimit, avancimin i drejtësisë restauruese bazuar në qasjen e individualizuar të manaxhimit të jështjeve, do të përfshijë, ndër të tjera, edhe ndryshimin e mendësisë mbizotëruese ende në sistemin e drejtësisë për të caktuar kryesisht dënimin me burgim.

Pas konsultimit me grupet e interesit, është dakordësuar logjika e mëposhtme e ndërhyrjes me qëllimet e politikës, 5 objektiva specifike dhe rezultatet e pritshme përkatëse:

Logjika e Ndërhyrjes	
➤	Qëllimi i Politikës 3: Sistemi i drejtësisë penale po zhvillohet mbi parimet moderne të drejtësisë evropiane, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut brenda një qasje të integruar dhe me praktika të forta për parandalimin e krimit.
➤	Objektivi Specifik 3.1: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të zinxhirit të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, resocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.
	▪ Rezultati 3.1.1 - Rishikimi dhe miratimi i Kodit Penal
	▪ Rezultati 3.1.2 - Rishikimi dhe miratimi i Kodit të Procedurës Penale
	▪ Rezultati 3.1.3 - Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjorë përkatëse që lidhen me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës penale.
	▪ Rezultati 3.1.4 Krijimi i një komisioni kombëtar për parandalimin e krimit dhe një sistem modern dhe efikas për parandalimin e krimit të zhvilluar dhe zbatuar, bazuar në bashkëpunimin midis institucioneve të sektorit të drejtësisë penale dhe autoriteteve sociale dhe arsimore
➤	Objektivi Specifik 3.2: Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv operacional sipas standardeve evropiane dhe hetim efikas dhe ndjekja e korrupsionit dhe e krimit të organizuar
	▪ Rezultati 3.2.1 – Prokuroria e Përgjithshme ka mekanizma të përmirësuar për monitorimin e veprimtarive lokale, procedura operationale të përcaktuara, numër personeli të përshtatshëm, eficiencë dhe produktivitet të përmirësuar në hetimet kundër pastrimit të parave, zbatim të përmirësuar të procesit të hetimit, përfshirje në punën me kërkimet mbi krimet dhe punë analitike përkatëse, dhe sistem efektiv për zbatimin e udhëzimeve të PP dhe DPPSH
	▪ Rezultati 3.2.2 – Zyrat e prokurorisë riorganizohen bazuar në hartën e re gjyqësore, të pajisura dhe operationet e tyre të përmirësuara, dhe efikasiteti i tyre i qendrueshëm.
	▪ Rezultati 3.2.3 – SPAK i plotësuar në staf dhe aktiviteti i tij i konsoliduar.
	▪ Rezultati 3.2.4 – BKH e krijuar dhe aktiviteti i saj i konsoliduar.
➤	Objektivi Specifik 3.3: Përmirësimi i drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre
	▪ Rezultati 3.3.1 - Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi.
	▪ Rezultati 3.3.2 - Garantimi i gjykimit të drejtë dhe të shpejtë, dhe i respektimit të të drejtave të njeriut për të miturit.
	▪ Rezultati 3.3.3 – Parandalimi i mbajtjes së të miturve në paraburgim, ulja e numrit të të miturve të dënuar, maksimizimi i përdorimit të shërbimit të provës për të miturit dhe i parandalimit të ri-përfshirjes së të miturve në krime.
	▪ Rezultati 3.3.4 – Risocializimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në konflikt me ligjin.
	▪ Rezultati 3.3.5 - Fuqizimi i bashkëpunimit midis autoriteteve (institucioneve) të sistemit të drejtësisë për të miturit.
➤	Objektivi Specifik 3.4: Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operationale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin,

riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së dhe është pranuar nga gjykatat dhe prokuroria si një alternativë e mirë ndaj burgimit.
Rezultati i pritshëm 3.4.1: Përditësimi i kuadrit ligjor me standardet evropiane, fuqizimi i kapaciteteve të brendshme institucionale dhe zotërimi nga ana e institucionit të burimeve të përshtatshme financiare, pajisje dhe infrastrukturë.
Rezultati i pritshëm 3.4.2: Përgatitja dhe rregullimi i përdorimit të punës para dënimit (kryesisht raportimi para dënimit, por gjithashtu zhvillimi i propozimeve për të shmangur ose pezulluar paraburgimin dhe duke ofruar mundësi për ndryshim), marrëveshjet me partnerët e sektorit të drejtësisë dhe zhvillimi i praktikave.
Rezultati i pritshëm 3.4.3: Përgatitja dhe rregullimi i opsioneve pa burgim, p.sh. dënime me burgim të pezulluara, me mbikëqyrje të shërbimit të provës, urdhra të komunitetit, punë në komunitet, arrest shtëpie (me ose pa Monitorim Elektronik), krijimi dhe zyrtarizimi i bashkëpunimit dhe marrëveshjeve me institucione të tjera të drejtësisë.
Rezultati i pritshëm 3.4.4: Puna e shërbimit të provës në lidhje me kujdestarinë me kontributin për të zhvilluar planet e paraburgimit të të burgosurve, përgatitjen për lirin e parakohshëm, këshillime nëse mund të jepet liri me kusht, rregullimi i punës, dhe krijimi e zyrtarizimi i bashkëpunimit me partnerët e sektorit të drejtësisë dhe zhvillimi i kësaj praktike
Rezultati i pritshëm 3.4.5: Shërbimet e provës punojnë në lidhje me “Lirin e Hershëm”: p.sh. përgatitja e kriterëve të pranueshmërisë për lirin, mbikëqyrja e shërbimit të provës, ndihmesa për të burgosurin e liruar para kohe me liri me kusht që të respektojë kushtet dhe ndihma ndaj personit për të kapërcyer problemin e tij/të saj kriminal, dhe krijimi e zyrtarizimi i bashkëpunimit përkatës me institucione të tjera të sektorit të drejtësisë dhe zhvillimi i kësaj praktike.
Rezultati i pritshëm 3.4.6: Shërbimi i provës ka kapacitete dhe infrastrukturë të përshtatshme për të punuar me të miturit
Rezultati i pritshëm 3.4.7: Përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit me organizatat dhe institucionet partnere.
➤ Objektivi Specifik 3.5: Zhvillimi i një sistemi efikas burgjesh bazuar në strategjinë për reformën e burgjeve në vazhdim, e cila siguron respekt të plotë për Burimet Njerëzore dhe përdor plane individuale për zhvillimin e çështjeve.
Rezultati 3.5.1 - Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor që lidhet me ndëshkimin në përputhje me planin e veprimit
Rezultati 3.5.2 – Kapacitetet organizative dhe të performancës të sistemit penitenciar janë fuqizuar dhe janë pajisur me burime të mjaftueshme.
Rezultati 3.5.3 – Fuqizimi i procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të të burgosurve.
Rezultati 3.5.4 – Përmirësimi i një shërbimi ndëshkues profesional, përmes trajnimeve të përqendruara dhe të qëndrueshme.
Rezultati 3.5.5 – Fuqizimi i mekanizmit të kontrollit të brendshëm, përmes sigurimit të një mandati më të gjerë dhe përmirësimit të kapaciteteve operacionale. Përmirësimi i integritetit, transparencës dhe llogaridhënies së koordinuar të proceseve në të gjitha nivelet në burgje.
Rezultati 3.5.6 – Fuqizimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor për të burgosurit, përfshirë kujdesin shëndetësor mendor.

- Rezultati 3.5.7 – Plani kombëtar i veprimit për ekstremizmin e dhunshëm në kontekstin e sistemit të burgjeve dhe zbatimit të shërbimit të provës.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur, Strategjia e Prokurorisë, strategjia e Shërbimit të provës dhe Strategjia e DPB do të japin shumë më tepër detaje për analizën, qasjen dhe aktivitetet specifike. Planet e veprimit bashkangjitur këtyre strategjive përshkruajnë në detaje masat prioritare të planifikuara dhe buxhetet e nevojshme për t'i zbatuar ato dhe për të arritur rezultatet e pritshme.

7 Qëllimi i Politikës 4 - MD dhe menaxhimi e koordinimi i sektorit

Ky qëllim i politikës bashkon elementë nga 3 prioritetet politikash (Qëllimet) që nga SND 2016-2020, përfshirë këtu fushën e teknologjisë së informacionit, MD dhe institucionet e saj të varësisë, dhe elementet që duhet të plotësohen në lidhje me profesionet e lira ligjore.

Përsa i përket MD-së dhe institucioneve të varësisë, raporti i vlerësimit të zbatimit të SND 2016-2020 konkludon se zbatimi i Planit të Zhvillimit të Kapaciteteve të MD-së do të jetë i rëndësishëm, ashtu sikurse do të jetë edhe zhvillimi i vazhdueshëm i fushës së kodifikimit dhe fushës së harmonizimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së. Për institucionet e varësisë, mbështetja për zhvillimin e menaxhimit për Shërbimin e Provës, burgjet dhe përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë do të jenë të rëndësishme. Fuqizimi i rregulloreve të inspektimit të MD-së dhe i kapaciteteve për mbikqyrjen e profesioneve të lira ligjore do të ketë gjithashtu një peshë të veçantë.

Në lidhje me teknologjinë e informacionit, nga raporti i vlerësimit të zbatimit të SND 2016-2020 rezulton se do të duhet të sigurohet që institucionet t'i japin përparësi kësaj fushe. Në këtë drejtim, duhet të sigurohet financim i mjaftueshëm dhe që niveli i ambicies të rritet ndjeshëm për të siguruar një *e-drejtësi* dhe zbatim të duhur që mund të mbështesin rritjen e efikasitetit në këtë sektor.

Bazuar në Planin e Zhvillimit të kapaciteteve të MD-së dhe në konsultime me palët përkatëse të interesit, janë propozuar shtatë objektiva specifike për të qenë pjesë e fazës tjetër të Strategjisë për periudhën 2021-2025:

Logjika e ndërhyrjes	Institucioni(et) përgjegjës(e)
➤ Qëllimi i Politikës 4: Koordinimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv i sektorit në të gjitha institucionet e sektorit të drejtësisë.	
➤ Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë virtuale (<i>e-drejtësia</i>) me një identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare (përfshirë zhvillimin e kapaciteteve institucionale, pajisjet, <i>software</i>).	Qendra e IT-së

Rezultati 4.1.1- Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore i përditësuar dhe plotësisht operacional bazuar në regjistrat elektronikë.	KLJGJ
Rezultati 4.1.2 - Krijimi dhe funksionimi i bazës së të dhënave gjyqësore, e cila mund të shërbejë për statistika dhe të dhëna në kohë reale bazuar në konceptin e përdorimit të një klasifikuesi të unifikuar për çështjet zinxhir të institucioneve të drejtësisë.	Qendra e IT-së
Rezultati 4.1.3 - Sistemi i menaxhimit të çështjeve të Prokurorisë i përditësuar dhe integruar dhe plotësisht funksional me kapacitete të mjaftueshme dhe sistem trajnimi i vazhduar dhe fleksibël për stafin përdorues të tij.	PP
Rezultati 4.1.4 - Krijimi dhe funksionimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.	Qendra e IT-së
Rezultati 4.1.5 - Institucionet e tjera të drejtësisë, duke përfshirë institucionet e varësisë të mbështetura në zhvillimin e zgjidhjeve të tyre të IT-së, përfshirë koordinimin me qendrën e IT.	Qendra e IT-së dhe institucionet e tjera përkatëse
➤ Objektivi Specifik 4.2: Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit.	MD dhe institucionet e tjera të sektorit
Rezultati 4.2.1 – Komitetet e koordinimit dhe monitorimit me pjesëmarrje të nivelit të lartë nga institucionet sektoriale të krijuara dhe që punojnë për secilën nga 4 Qëllimet e Politikës.	MD dhe institucionet e tjera të sektorit
Rezultati 4.2.2 – Kapacitetet monitoruese dhe bashkërenduese të MD-së do të rriten veçanërisht në lidhje me cilësinë e kapaciteteve analitike dhe raportuese.	MD
Rezultati 4.2.3 – Statistikat e sektorit do të përmirësohen për t'u përputhur me standardet evropiane dhe bazuar në planet e veçanta institucionale, planet individuale institucionale të menaxhimit të performancës zhvillohen në bashkëpunim me MD dhe institucionet kyç të sektorit (MD, KLJGJ/Gjykatat, KLP, ILD, PP, DNJF, SHP, SHB) dhe përdoren në mënyrë aktive për raportime dhe në funksion të përmirësimit të dhënies së shërbimeve.	MD, MF dhe institucionet e tjera të sektorit
Rezultati 4.2.4 – Rritja e kapaciteteve të komunikimit (ndërinstitucional, ndërsektorial dhe të jashtëm) duke mundur një shkallë më të lartë dhe cilësi të përmirësuar të njohurive të jashtme të sektorit, komunikimin e përmirësuar midis institucioneve në sektor dhe kapacitetet e përmirësuara të komunikimit institucional të sektorit.	MD dhe institucionet e tjera të sektorit
➤ Objektivi Specifik 4.3: Zhvillimi i kapaciteteve të MD-së dhe rritja e burimeve, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e saj vartëse, p.sh. nëpërmjet mbështetjes specifike të menaxhimit/zhvillimit të kapaciteteve për institucionet e përzgjedhura¹⁴ (p.sh. Përmbaruesit)	MD
Rezultati 4.3.1 – MD ka përfunduar zbatimin e planit të saj të zhvillimit të kapaciteteve nga 2018/19	MD

¹⁴ Me përjashtim të atyre (ndihma juridike, shërbimi i provës dhe burgjet), të cilat synohen nga objektiva të tjerë specifikë.

Rezultati 4.3.2 – Nevojat e zhvillimit të kapaciteteve për institucionet e tjera të varësisë (që lidhen me drejtësinë) të ndërmarra dhe veprimet për zhvillimin e kapaciteteve të zbatuara aty ku është e nevojshme.	MD dhe Institucionet e Varësisë
Rezultati 4.3.3 – Metodologjitë për inspektimin e Përmbaruesve dhe Noterëve janë përfunduar, miratuar dhe zbatuar siç duhet dhe personeli i duhur dhe burimet e tjera janë alokuar për zbatim.	MD
➤ Objektivi Specifik 4.4: Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar global, dhe Shqipëria ëërgatitet për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me <i>acquis</i> e BE dhe aktet e tjera të integritimit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë	MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 4.4.1 – Rishikohet kuadri ligjor në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.	MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 4.4.2 – Kapacitetet dhe burimet e Shqipërisë (kryesisht MD) në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet juridike penale dhe civile, duke përfshirë fushën e të Drejtave të Njeriut janë rritur dhe aktivitetet në këtë fushë kryhen në mënyrë efikase dhe efektive.	MD, QSH, Kuvendi
Rezultati 4.4.3– Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me <i>acquis</i> e BE-së realizohet në një fazë dhe në një cilësi në përputhje me MSA dhe kuadrin negociator.	MD, QSH Kuvendi
Rezultati 4.4.4 – Kapacitetet e MD dhe institucioneve sektoriale për të menaxhuar modalitetet e mbështetjes buxhetore të BE-së janë zhvilluar në mënyrën e duhur dhe sektori i drejtësisë merr mbështetje të konsiderueshme financiare nga këto fonde.	MD, QSH, Kuvendi

Detaje të mëtejshme në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve të MD-së mund të gjenden në planin e zhvillimit të kapaciteteve të MD-së dhe në dokumentacionin në lidhje me zhvillimin e departamentit të kodifikimit. Së fundmi, më shumë detaje dhe buxhete në lidhje me masat prioritare për të arritur rezultatet e propozuara mund të gjenden në planet e veprimit dhe buxhetet në lidhje me secilin prej objektivave specifike të ngarkuar në IPSIS.

PJESA III: ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI

8 Mbështetja e strategjive për SND 2021-2025

- Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve të MD-së
- Plani Strategjik për burgjet
- Plani i Drejtësisë për të Mitur
- Plani Strategjik për Shërbimin e Provës
- Plani Strategjik për Ndihmën Juridike
- Strategjia e Përmbarimit gjyqësor
- Plani strategjik i KLGJ-së (që do të finalizohet si plan afatmesëm-afatgjatë)
- Plani strategjik i KLP-së
- Plani i PP-së
- Plani strategjik i ILD-së
- Plani strategjik i SHM-së

Strategji Paralele

- SKZHI si Strategji kuadër
- Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
- Strategjia e Edukimit Ligjor për pPublikun
- Strategjia Kombëtare e Reformës në Administratën Publike

9 Koordinimi, Monitorimi dhe Menaxhimi i Performancës

Fusha e koordinimit, monitorimit dhe menaxhimit të performancës ka qenë një sfidë në fazën gjatë zbatimi të reformës në drejtësi. Në zbatim të VKM nr. 773, datë 2.11.2016, mbi miratimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka menaxhuar mekanizmin institucional për monitorimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë. Mekanizmi institucional për monitorimin e kësaj strategjie realizohet nëpërmjet një strukture të veçantë, në përbërjen e të cilës janë:

- Zëvendësministri i Drejtësisë;
- 5 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Ministrave që mbulon çështjet e koordinimit të dokumenteve strategjike;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- 1 përfaqësues nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë;
- 1 përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese;
- 1 përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;
- 1 përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës;

- 1 përfaqësues nga Avokati i Popullit;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterëve;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

Përsa më sipër të gjitha institucionet kanë përcaktuar përfaqësuesit e tyre në mekanizimin e monitorimit. Ky mekanizëm vlerëson dhe miraton raportet periodike të Monitorimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Për më tepër, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, janë krijuar 5 Komitete Drejtuese Sektoriale (KDS). Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është parashikuar ngritja e Komitetit Drejtues Sektorial (KDS) për Reformën në Drejtësi.

Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi, drejtohet nga Ministri i Drejtësisë në cilësinë e kryetarit dhe ka anëtarë të tjerë:

- o Ministrin e Brendshëm;
- o Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- o Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- o Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
- o Kabinetin e Kryeministrit (ZOS, Këshilltarë);
- o Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri;
- o Departamentin e Burimeve, Transparencës dhe Miradministrimit, në Kryeministri.

Të ftuar: Përfaqësues nga Kuvendi, KLP, KLGJ, KED, PP, SHM, ILDKPKI, Avokati Popullit, Dhomat Kombëtare (të Avokatisë, Noterëve, Ndërmjetësve, Përmbaruesve), Donatori/Pika fokalepër fushën etj., si dhe të tjerë, sipas vendimmarrjes nga drejtuesi i KDS-së.

KDS siguron një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe
- promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

Në kontekstin e integritimit evropian, këto struktura do të luajnë rolin e Komitetit Sektorial Monitorues për projektet IPA, duke siguruar raportimin e monitorimit të fondeve IPA, sipas

sektorëve.

Lidhur me raportet e monitorimit të zbatimit të masave të planit të veprimit të SND duhet theksuar se çdo institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të masave, procesi i monitorimit kryehet në nivel objektivi. Verifikimi i të dhënave të raportuara kryhet pjesërisht online, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor i të dhënave kryhet nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura. Këto raporte janë kryesisht të një karakteri narrativ, por edhe statistikor duke përdorur tregues të kufizuar performance. Pasaporta e Indikatorëve e hartuar për të ndjekur rezultatet e reformës nuk është përdorur në mënyrë aktive pasi disa institucione nuk i konsideronin veprimtari të caktuara pjesë e kompetencave të tyre, pasi këto tregues ishin vendosur me institucionet paraardhëse, përpara krijimit të institucioneve të reja të drejtësisë. Statistikat në sektor përgjithësisht jepen me shumë vonesë, pasi secili institucion raportues ka afatet e veta në përpunimin e të dhënave statistikore të cilat nuk përputhen me kohën e raportimit të treguesëve.

Ka një konsensus midis të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë mbi nevojën për të përmirësuar sistemin e komunikimit, koordinimit, monitorimit dhe menaxhimit të performancës për të arritur rezultatet më të mira të mundshme të zbatimit të SND 2021-2025. MD do të vazhdojë të luaj rol in e Sekretariatit Teknik në mbështetje të KDS.

Me fuqizimin e pavarësisë së disa prej institucioneve në sektor, ka marrëveshje për të respektuar sistemet e planifikimit të brendshëm dhe raportimin e këtyre institucioneve në shkallën e mundshme. Me qëllim garantimin e një raportimi cilësor të shërbimeve brenda sektorit është rënë dakord të përcaktohen qartë treguesit kundrejt të cilëve secili institucion do të raportojë për KDS, si dhe për dhe në pranë Kuvendit, qytetarëve shqiptarë si dhe partnerëve ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, është e domosdoshme përcaktimi i një pasaporte të qartë treguesish, përfshirë treguesit e rezultateve për të gjithë institucionet e përfshira në zbatimin e secilit objektiv specifik.

10 Komunikimi i Strategjisë

Një studim i palëve të interesit i zhvilluar në vitin 2018 në lidhje me përgatitjen e planit për zhvillimin e kapaciteteve të MD-së, si dhe diskutimet me palët e interesuara të sektorit gjatë përgatitjes së SND 2021-2025 dëshmon se njohuritë e publikut të gjerë mbi reformën në drejtësi dhe zhvillimet në sektor janë relativisht të pakta. Përveç iniciativave specifike për të rritur transparencën në sektor, kjo Strategji përfshin Rezultatin 5.2.3: “Përmirësimi i aftësive të komunikimit (si në nivel ndër-institucional, ndër-sektoral, ashtu edhe të jashtëm) që lejojnë një shkallë më të lartë dhe cilësi të përmirësuar të njohjes së sektorit nga jashtë, përmirësimi i komunikimit midis institucioneve në nivel sektori dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale të komunikimit në sektor”.

Plani përkatës i veprimit përfshin masat dhe synimet përkatëse prioritare për materializimin e këtij rezultati. Synimi është që deri në fund të vitit të parë të zbatimit të SND 2021-2025, shumica dërrmuese e popullsisë të ketë informacion mbi impaktin e reformës tek ta, 90% e aktorëve të sektorit do të kenë njohuri të qarta të përmbajtjes së reformës, si dhe pritshmëritë lidhur me punën dhe rezultatet e institucioneve të tyre. Gjithashtu, përpjekjet për të arritur rezultatin e pritshëm do të mbështeten nga asistenca teknike e BE-së.

DRAFT

11 Matrica e manaxhimit të riskut

Më poshtë janë paraqitur rreziqet kryesore të përgjithshme të përshkruara së bashku me masat e propozuara të zbutjes së riskut. Për më tepër, shumë nga planet individuale institucionale përmbajnë matrica të menaxhimit të rrezikut dhe masa përkatëse për zbutjen e tyre. Matrica e manaxhimit të rrezikut do të monitorohet në bazë 6-mujore si pjesë e monitorimit të progresit.

Përshkrimi i Riskut	Niveli i Vlerësuar i Riskut	Ndikimi i Mundshëm	Veprimet Lehtësuese
Domethënia e ngjyrave:	Pa ngjyrë Risk i ulët	Risk mesatar	Risk i lartë
I. Risqet e lidhura politikisht			
a) Humbet mbështetja politike për rivlerësimin kalimtar dhe reformën e qeverisjes së sistemit të drejtësisë	Mesatar	I lartë	- Komunikimi në mënyrë të rregullt i progresit të arritur - MD dhe organet e qeverisjes mbajnë marrëdhënie të ngushta me anëtarët përkatës të Kuvendit dhe partitë politike - Duhet treguar gatishmëri për të vlerësuar ndryshimet e kërkuara nga politikanët
b) Procesi i rivlerësimit kalimtar vonohet edhe më tej, p.sh. për shkak të krizës së shkaktuar nga Covid-19 dhe procesi nuk do të përfundojë	I lartë	I lartë	Monitorim nëse KPK po funksionon në mënyrë të shpejtë në përputhje me rrethanat

përpara fundit të mandatit të KPK-së, duke ja lënë KLGJ-së dhe KLP-së për të përfunduar procesin, gjë të cilës ata mund të mos i japin prioritet			Duhet riparë mundësia që ONM të vazhdojë mbikëqyrjen e procesit me të drejtë ankese nëse/kur ajo ndërmerret nga KLGJ dhe KLP.
c) Rezultati i çështjeve të KEDNJ-së të apeluara nga subjektet e rivlerësimit mund të ndikojë në procesin dhe procedurën e rivlerësimit kalimtar (vetting)	I ulët	Mesatar	Monitorim i situatës dhe përgatitje të përgatitur për të modifikuar procedurat që sigurojnë të njëjtën cilësi të procesit
d) Mungesa e mbështetjes politike për përditësimin e legjislacionit dhe procedurave të drejtësisë penale me standardet moderne evropiane bazuar në të drejtat e njeriut dhe parimet e drejtësisë restauruese	Mesatar	Mesatar	- Ndërmarrja e analizave për situatën shqiptare dhe hendekun drejt standardeve evropiane përpara se të paraqiten iniciativat ligjore në lidhje me drejtësinë penale - Në këtë kontekst duhen vlerësuar veçanërisht opsionet e hulumtimit të modeleve evropiane për koordinimin e sektorit të drejtësisë penale dhe punës për parandalimin e krimit
e) Mungesa e mbështetjes politike për të vendosur masa për të përmirësuar cilësinë e arsimit universitar juridik.	Mesatar	I ulët	Duhet siguri maksimale që është kryer një analizë e thelluar paraprake dhe propozimet përgatiten mirë para se të paraqiten Duhet të vlerësohen mënyrat e përmirësimit, të cilat nuk kanë nevojë për ndryshime legjislative nga Kuvendi
II. Koordinimi i sektorit dhe risqet në komunikim			
a) Mungesa e vullnetit nga Institucionet e Pavarura të Drejtësisë për të	I lartë	I lartë	Duhet të sigurohet komunikim dhe mirëkuptim ndërmjet drejtuesëve të lartë në institucionet e

komunikuar dhe bashkëpunuar pozitivisht në koordinimin e sektorit			qeverisjes të sistemit të drejtësisë dhe në institucionet e pavarura Duhet sqaruar në vijimës për të të gjithë drejtuesit se progresi në angazhimet ndërkombëtare dhe ato në kuadër të integritetit më BE, në lidhje me sektorin e drejtësisë kërkojnë bashkëpunim midis të gjithë aktorëve të sektorit të drejtësisë.
b) Mungesa e njohurive dhe mirëkuptimit në publikun e gjerë, por edhe midis profesionistëve në sektor për përmbajtjen dhe rëndësinë e SND	Mesatar	I ulët	Zbatimi i sigurt i strategjive të komunikimit të përfshira në Strategji
c) Moskuptimi nga organet e gjyqësorit lidhur me pritshmëritë e publikut për transparencë në sistemin e drejtësisë	I lartë	Mesatar	Zbatimi i anketimit lidhur me perceptimin dhe dhe më zhvillimi i një politike dhe strategji transparence me gamë të gjerë
d) Mungesa e vullnetit të institucioneve të sektorit të drejtësisë penale për të bashkëpunuar në një qasje të përbashkët për drejtësinë penale në përputhje me objektivat e reformës	I ulët/Mesatar	Mesatar/I lartë	Duhet të sigurohet që propozimet të jenë rezultat I një analize të përgatitur mirë përpara se të paraqiten pranë organeve drejtuese të drejtësisë penale
e) Mungesa e koordinimit midis institucioneve të sektorit për avancimin e një drejtësie elektronike moderne	Mesatar	I lartë	Zhvillimi i një propozimi solid për e-drejtësi të zhvilluar në mënyrë koherente, të qëndrueshëm edhe teknikisht, edhe financiarisht, që dokumenton efikasitetin dhe përfitimet nga funksionimi i saj.
III. Risqet institucionale			

f) Procesi i rivlerësimit kalimtar krijon një numër të madh vendesh të lira pune dhe në vitin 2024 do të jenë bosh pothuajse gjysma e pozicioneve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistem nëse nuk merren masa	I lartë	I lartë	Zbatimi i një udhërrëfyese tranzicioni siç është propozuar nga ekspertët dhe MD (shih hartën e veçantë për masa të hollësishme)
g) Vonesa e zbatimit të hartës së re gjyqësore	Mesatar	Mesatar	- Duhet të sigurohet mbështetjen e nevojshme politike dhe teknike për vendimet dhe zbatimin e hartës - Duhet të kostohe në detaje krijimi i hartës dhe infrastrukturës së re dhe sigurimi i burimeve të nevojshme financiare për vënien në zbatim të hartës
h) Mungesa e vullnetit të institucioneve të drejtësisë për të dërguar çështjet/kategoritë e çështjeve tek strukturat ZAM	Mesatar	I ulët	Duhet të sqarohen gjerësisht përfitimet e mundshme të efikasitetit dhe sigurohuni që fitimet e tilla të efikasitetit nga dorëzimi në ARM të mbahen nga institucionet e drejtësisë
i) Mungesa e Mbështetjes nga KM dhe institucionet e reformës në sektorin publik për të zbatuar ZAM në lidhje me mekanizmat e përmirësuar të ankimeve administative	Mesatar	I ulët	- Nevoja për të studiuar mirë praktikat më të mira evropiane dhe për të paraqitur propozime të përpunuara mirë për KM - Nevoja për të vërtetuar kostot dhe efikasitetin e stafit
IV. Risqet që lidhen me Financën dhe burimet			
j) Mungesa e burimeve financiare nga MFE dhe donatorët për sektorin dhe elementët kryesorë të reformës, duke përfshirë përforsimet e nevojshme të	I lartë	I lartë	Në situatën e mungesës së burimeve financiare, duhet të të identifikohen dhe arrihen fitime të mundshme efikasiteti/nga kursimet

buxhetit të NDJF dhe Shërbimit të Provës			• Nevojat financiare të sektorit duhet të shihen në tërësi dhe të merren në konsideratë rialokimet e mundshme ndërinstitucionale • Sektori të marrë maksimumin e mundshëm nga mbështetja e buxhetit të BE-së për reformën dhe që burimet të mos devijohen në sektorë të tjerë
k) Mungesa e burimeve të personelit të kualifikuar për kërkesat shtesë të institucioneve për shkak të reformave	I lartë	Mesatar	• Rritja e efikasitetit brenda institucioneve • Duhet marrë në konsideratë rialokimet e mundshme të buxhetit me institucionet • Duhet garantuar që përshkallëzimi i sistemit të pagave në sektor është i harmonizuar siç duhet me pjesën tjetër të sektorit publik • Siguroni informacionin e duhur për profesionistët e rinj në lidhje me karrierën dhe mundësitë e rritjes profesionale në sektor
l) Mungesa e aktorëve të sektorit dhe OJQ-ve për të pranuar sisteme rikuperuese të kostos nëpërmjet rregullimeve të tarifave gjyqësore që parandalojnë paditë e pathemlata dhe sigurojnë nivele të arsyeshme të rikuperimit të kostos	Mesatar	Mesatar	• Duhet të dokumentohen përfitimet e sistemeve të rikuperimit të kostos dhe të mbajtjes së një niveli tarife që pengon pretendimet e pathemlata
m) Mungesa e burimeve financiare për investime në institucione të specializuara për të mitur dhe në sistemin e burgjeve	I lartë	Mesatar/I lartë	• Duhet garantuar me kujdes planifikimi i nevojave për investime dhe vlerësimi i zhvillimit të një plani investimi 10-vjeçar
V. Riske të tjera			

n) Mungesa e prioritizimit nga institucionet e drejtësisë për shpenzimet e IT-së	I lartë	I lartë	• Nevoja për të zhvilluar një plan të mirëdokumentuar zhvillimi të <i>e-drejtësisë</i>, i cili identifikon efikasitetin, përfshirë efikasitetin e kostos, përfitimet dhe diskutimin me aktorët e sektorit
--	---------	---------	---

DRAFT

Pjesa IV – KONSIDERATA FINANCIARE

12 Buxheti i Strategjisë

BUXHETI indikativ per zbatim. Buxheti indikativ për zbatimin e strategjisë tregohet në tabelat e mëposhtme (tabela 1 në Euro, tabela 2 në Lekë). Opsioni 1 përfshin shpenzime themelore dhe shtesa të vogla për Shërbimin e Provës, Ndihmën Juridike Falas, si edhe investimet IT të nevojshme në të gjithë institucionet e përfshira në strategji. Ky opsion përfshin edhe shpenzimet e parashikuara për krijimin e një qendre mjekësore për të dënuarit e sëmurë mendorë siç rekomandohet nga Këshilli i Evropës dhe BE, si dhe përfshin 4 milion Euro për ndërtimin e një gjykate të apelit në Tiranë. Opsioni 2 përfshin shtesë 20 milion Euro për godina gjykate, Shërbimin e Provës dhe përmirësimin e burgjeve për zbatim gjatë 2022 deri 2025.

Vlen të theksohet se në këtë opsion nuk është përfshirë si shpenzim shuma prej prej 20 milion Euro për Asistencë Teknike, duke qenë se është ndihmë e ofruar në natyrë. Nga ana tjetër, kjo asistencë në natyrë për sektorin është gjithashtu një hamendësim sipas PBA dhe nuk është buxhetuar dhe nuk është llogaritur sipas buxhetit të shtetit. Asistenca Teknike në natyrë mbulon praktikisht të gjitha nevojat për konsulencë, studime dhe shumë vlerësime, etj., të institucioneve në sektor, kështu shpenzime shtesë për këto aktivitete nuk janë përfshirë në buxhetin e reformës në Opsionin 1 dhe Opsionin 2. Theksohet se mbështetja buxhetore e parashikuar nga BE për 2021-2025 është në shumën midis 40-45 milion Euro, kështu që Opsioni 1 qëndron mirë me mbështetjen e parashikuar nga BE. Më tej, ka angazhime financiare paraprake nga BE, BB dhe Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës për financimin e ndërtimit të qendrës mjekësore të burgjeve për 13 milion Euro.

Të gjitha tabelat e buxhetit janë hartuar në bazë të formative IPSIS, në përputhje me kuadrin rregullator për planifikimin e integruar. janë ngarkuar në formatet e duhura IPSIS.

Totali (Opsioni 0) në Lekë dhe Euro dhe kalimi i shpenzimeve (opsioni 1) në Euro.

Opsioni 2 përfshin investimin shtesë në infrastrukturën gjyqësore.

Totali (Opsioni 0) në Lekë dhe Euro dhe kalimi i shpenzimeve (opsioni 1) në Euro. Opsioni 2 përfshin investimin shtesë në infrastrukturën e gjykatës.											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024*		Viti 2025*		Totali
	Kostot e përsëritura	Investime	Kosto të përsëritura	Investime	Kosto të përsëritura	Investime	Kosto të përsëritura	Investime	Kosto të përsëritura	Investime	
Opsioni 0	12 495 800	1 108 700	12 745 500	997 500	13 137 250	886 800	13 137 250	886 800	13 137 250	886 800	69 419 650
Opsioni 0 në Euro	101 115 067	8 971 516	103 135 621	8 071 694	106 305 632	7 175 918	106 305 632	7 175 918	106 305 632	7 175 918	561 738 550
Opsioni 1	295 842	4 458 126	616 332	3 386 193	936 822	2 270 258	1 150 482	9 900 939	1 364 142	9 650 073	34 029 210
O1 në % prej O0	0%	50%	1%	42%	1%	32%	1%	138%	1%	134%	6%
Opsioni 2**	295 842	4 458 126	616 332	8 386 193	936 822	7 270 258	1 150 482	14 900 939	1 364 142	14 650 073	54 029 210
O2 në % prej O0	0%	50%	1%	104%	1%	101%	1%	208%	1%	204%	10%
Shënim*	Parashikim për rritje zero nga 2023 për opsionin 0										
Shënim **	Përfshin 4 milion euro për gjykatat e apelit në Tiranë dhe 13 milion Euro për mjediset mjekësore në burgje.										
Shënim ***	Përfshin përlogaritjen bruto për investimin shtesë në infrastrukturën e gjykatave dhe prokurorive në lidhje me hartën e re gjyqësore për 20 milion euro, gjë e cila është 1/2 e shpenzimeve të përlogaritura për planin e veprimit 2019/21 për infrastrukturën e gjykatave.										
Në 1000 Lekë											
Opsioni 0	12 495 800	1 108 700	12 745 500	997 500	13 137 250	886 800	13 137 250	886 800	13 137 250	886 800	69 419 650
Opsioni 1	36 560	550 935	76 166	418 466	115 772	280 558	142 177	1 223 558	168 581	1 192 556	4 205 330
Opsioni 2	36 560	550 935	76 166	1 036 366	115 772	898 458	142 177	1 841 458	168 581	1 810 456	6 676 930

Tabela 2:

Gjykata Kushtetuese											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	151 000	4 000	156 500	4 000	159 500	4 000					479 000
Opsioni 0 në Euro	1 221 881	32 368	1 266 386	32 368	1 290 662	32 368	-	-	-	-	3 876 032
Opsioni 1											
Opsioni 2											
Këshilli i Lartë i Prokurorisë											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	144 000	20 000	145 000	10 000	149 000	10 000					478 000
Opsioni 0 në Euro	1 165 237	161 838	1 173 329	80 919	1 205 697	80 919	0	0	0	0	3 867 940
Opsioni 1											
Opsioni 2											
Prokuroria e Përgjithshme											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	2 240 000	180 000	2 240 000	130 000	2 243 800	130 000					7 163 800
Opsioni 0 në Euro	18 125 910	1 456 546	18 125 910	1 051 950	18 156 660	1 051 950	0	0	0	0	57 968 927
Opsioni 1											
Opsioni 2											
Shkolla e Magjistraturës											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	185 500	60 000	190 000	60 000	193 000	60 000					748 500
Opsioni 0 në Euro	1 501 052	485 515	1 537 466	485 515	1 561 741	485 515	-	-	-	-	6 056 805
Opsioni 1											
Opsioni 2											
Këshilliri i Lartë Gjyqësor+ IT centre											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	2 960 500	178 000	3 252 700	200 000	3 281 650	200 000					10 072 850
Opsioni 0 në Euro	23 956 142	1 440 363	26 320 602	1 618 385	26 554 863	1 618 385	-	-	-	-	81 508 739
Opsioni 1									2 000 000	2 000 000	4 000 000
Opsioni 2											
Apel court building Titana according to feasibility study:					4 000 000						
SPAK											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	470 000	30 000	470 000	10 000	470 000	20 000					1 470 000
Opsioni 0 në Euro	3 803 204	242 758	3 803 204	80 919	3 803 204	161 838	-	-	-	-	11 895 129
Opsioni 1											
Opsioni 2											
Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0	193 000	52 000	195 000	2 000	195 000	2 000					639 000
Opsioni 0 në Euro	1 561 741	420 780	1 577 925	16 184	1 577 925	16 184	0	0	0	0	5 170 740
Opsioni 1											
Opsioni 2											
IT ne institucionet e pavarura											
	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025		Totali
	Kostot përsëritura	e Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	Kosto përsëritura	të Investime	
Opsioni 0											
Opsioni 1		2 396 420		2 313 420		1 713 420		563 420		563 420	7 550 100
Opsioni 2											

PJESA V: Anekset me planet e veprimit, treguesit dhe buxhetet e hollësishme

Shtojca 1: Planet e veprimit me afate kohore, përfshirë aktivitetet kryesore objektive specifike, dhe treguesit e rezultateve për të gjitha qëllimet specifike në lidhje me MD, institucionet e varësisë, IT dhe SHM.

Shtojca 2: Dokumentet e strategjisë për KLGJ, KLP, ILD, Drejtësia për të Mitur.

Shtojca 3: Pasaporta e Treguesve

Shtojca 4 (në excel): Buxhete të hollësishme

DRAFT